



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATURA E SHTETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 5427 Prot.

Tiranë, më 23.06. 2026

Lënda: Dërgohet Raporti i Avokaturës së Shtetit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së, për periudhën janar – dhjetor 2025.

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

ZOTIT NIKO PELESHI - KRYETAR

Tiranë

I nderuar Zoti Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 19/9 të Ligjit nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” (i ndryshuar), brenda kompetencave që ka Avokatura e Shtetit, më Lejoni t’ju dërgoj bashkëlidhur: *Raportin e Avokaturës së Shtetit “Për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për periudhën janar – dhjetor 2025.*

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin!

Me konsideratë të lartë,

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA



AVOKATURA E SHTESTIT

RAPORTI 2025

www.avokaturashtetit.gov.al

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje.....	3
1. VENDIMMARRJA E GJEDNJ-SË PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2025.....	4-15
1.1. Çështje të komunikuar dhe të përfaqësuara në GJEDNJ.....	5
1.2. Vendime gjyqësore të dhëna nga GJEDNJ.....	5-6
1.3. Kërkesa të pranuar nga GJEDNJ dhe shkeljet e konstatuara.....	6-11
1.4. Kërkesa të zgjidhura me marrëveshje miqësore.....	11
1.5. Vendime lidhur me çështjet e vettingut.....	11-12
1.6. Kërkesa të shpallura të papranueshme.....	12-15
2. EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË GJEDNJ-SË GJATË PERIUdhËS JANAR-DHJETOR 2025.....	15-17
2.1. Përmbledhje ekzekutive.....	15
2.2. Çështjet në monitorim.....	15
2.3. Planet dhe raportet e veprimit.....	15
2.4. Arritjet kryesore në vitin 2025.....	15-16
2.5. Çështjet e mbyllura nga Komiteti i Ministrave të KiE-së.....	16
2.6. Pagesa e shpërblimit të drejtë.....	16
2.7. Botimi në Fletoren Zyrtare dhe masa të tjera ndërgjegjësuese.....	16- 17
3. RAPORTIMET PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE TË GJEDNJ-SË NË KOMITETIN E MINISTRAVE TË KËSHILLIT TË EVROPËS.....	17-27
3.1. Vendime me procedurë të përshpejtuar.....	17-23
3.2. Vendime me procedurë normale.....	23-27
4. AKTIVITETE DHE PROJEKTE TË AVOKATURËS SË SHETIT.....	27-28

Hyrje

Avokatura e Shtetit ushtron aktivitetin e saj në bazë të Ligjit nr. 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet e saj me institucionet shtetërore dhe entet publike.

Në zbatim të nenit 19/2 të këtij ligji, Avokatura e Shtetit (në vijim ASH) paraqet raport të paktën një herë në vit përpara Komisionit të Përhershëm për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, mbi ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe masat e ndërmarra në këtë drejtim.

Ky raport reflekton veprimtarinë e Avokaturës së Shtetit për periudhën janar–dhjetor 2025, duke përmbledhur vendimmarrjen e GJEDNJ-së për Shqipërinë gjatë vitit 2025, çështjet e komunikuar dhe të përfaqësuara, vendimet me konstatim shkeljeje, vendimet e papranueshmërisë, zgjidhjet me pajtim dhe masat e ndërmarra për ekzekutimin e vendimeve.

Gjatë vitit 2025, Avokatura e Shtetit ka trajtuar çështje që lidhen me mbrojtjen dhe përfaqësimin e shtetit shqiptar pranë GJEDNJ-së, si edhe me hartimin dhe dërgimin e informacionit për ekzekutimin e vendimeve pranë Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

Në përfaqësimin pranë Gjykatës janë trajtuar gjithsej 54 çështje, me fokus kryesor pretendimet për shkelje të nenit 6 të Konventës (e drejta për një proces të rregullt ligjor), nenit 5 (e drejta për liri dhe siguri), nenit 8 (jeta private dhe familjare), si dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 (mbrojtja e pronës).

Gjatë vitit 2025, GJEDNJ ka dhënë 34 vendime për 44 kërkesa kundër Shqipërisë. Nga këto, GJEDNJ ka konstatuar shkelje të Konventës vetëm në 12 vendime; në 16 vendime kërkesat janë shpallur të papranueshme; ndërsa në 6 vendime çështjet janë nxjerrë nga lista e gjykimit, kryesisht për mungesë interesi ose për shkak të zgjidhjes me pajtim/deklaratave të njëanshme.

Në këto çështje, kërkuarit kanë kërkuar shpërblim në vlerën 1,700,249,493 lekë, ndërsa Gjykata ka akorduar në total 7,898,436 lekë. Për rrjedhojë, nga mbrojtja dhe përfaqësimi i interesave pasurore të shtetit është shmangur një dëm i mundshëm financiar në vlerën 1,692,351,057 lekë.

Vendimmarrja e vitit 2025 evidenton vijimin e problematikave të lidhura me tejzgjatjen e procedurave, aksesin në Gjykatën Kushtetuese, arsyetimin e vendimeve gjyqësore, paanshmërinë e gjykatës, elemente të tjera të procesit të rregullt ligjor, të drejtën e pronës dhe çështjet e vettingut. Raporti përmbledh gjetjet kryesore të Gjykatës dhe rekomandimet përkatëse të Avokaturës së Shtetit për institucionet përgjegjëse.

Sa i përket ekzekutimit të vendimeve, gjatë vitit 2025 Avokatura e Shtetit ka iniciuar procedurat për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së dhe ka ndjekur procedurat e pagesës së shpërblimit të drejtë, botimin e vendimeve në Fletoren Zyrtare dhe komunikimet me institucionet përgjegjëse për masat individuale dhe të përgjithshme.

Në vitin 2025, GJEDNJ ka dërguar në Komitetin e Ministrave 13 çështje kundër Shqipërisë për mbikëqyrjen e ekzekutimit të tyre. Aktualisht janë 63 çështje në monitorim nga Komiteti i Ministrave, nga të cilat 7 ndiqen me procedurë të përshpejtuar. Gjatë vitit janë dërguar 27 plane/raporte veprimi dhe komunikime të përditësuara, ndërsa Komiteti i Ministrave ka mbyllur monitorimin për 8 çështje, përfshirë edhe çështje me rëndësi të veçantë për jurisprudencën kundër Shqipërisë.

Raporti përfshin gjithashtu aktivitetet dhe projektet e tjera të Avokaturës së Shtetit gjatë vitit 2025, përfshirë bashkëpunimin me Zyrën e Këshillit të Evropës në Tiranë dhe kontributin institucional në raportime të ndryshme lidhur me të drejtat e njeriut, gjyqësorin dhe shtetin e së drejtës.

1. VENDIMMARRJA E GJEDNJ-SË PËR PERIUDHËN JANAR–DHJETOR 2025

1. VENDIMMARRJA E GJEDNJ-SË PËR PERIUDHËN JANAR–DHJETOR 2025


Gjatë vitit 2025, nga avokatët e Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja Ndërkombëtare dhe Arbitrazhin Ndërkombëtar janë trajtuar çështje përsa i përket; (a) mbrojtjes dhe përfaqësimit në GJEDNJ, (b) hartimit dhe dërgimit të informacionit për ekzekutimin e vendimeve të Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve në GJEDNJ dhe Komitetit të Ministrave të KiE-së.

Në përfaqësimin pranë Gjykatës për këtë vit janë trajtuar gjithsej 54 çështje (8 më shumë se viti 2024), të cilat kanë pasur në fokus të tyre kryesisht procesin e rregullt ligjor (neni 6 i Konventës), e drejta për liri dhe siguri (neni 5 i Konventës), e drejta familjare (neni 8) si dhe të drejtën e pronës (Neni 1 i Protokollit 1).

Gjatë këtij viti, Gjykata ka dalë me 34 vendime, për 44 kërkuar. Në këto çështje, kërkuarit gjatë gjyqimit, kanë kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerë financiare prej **1,700,249,493** (Njëmiliard e shtatëqindmilion e dyqindedyzetënëntëmijë e katërqindënëntëdhjetëetë) Lekë¹, ndërsa Gjykata ka pranuar në total një shpërblim dëmi në vlerën **7,898,436** (Shtatëmilion etetëqindënëntëdhjetëetëetëmijë ekatërqindetridhjetëegjashtë) Lekë.

Nga Avokatura e Shtetit është arritur të shmangët një dëm financiar ndaj interesave pasurore të shtetit prej **1,692,351,057** (Njëmiliard e gjashtëqindënëntëdhjetëedymilion e treqindpesëdhjetëenjëmijë e pesëdhjetëeshtatë) Lekë.

Grafiku sipas vlerës GJEDNJ



¹ Kursi i konvertimit është marrë ai i datës 21.01.2025.

Në formë tabelare dhe grafike çështjet pranë zyrës së përfaqësimit në GJEDNJ për vitin 2025 paraqiten si vijon:

Nr.	ÇËSHTJET E TRAJTUARA	
1	Çështje të komunikuar nga GJEDNJ	31
2	Çështje të përfaqësuara	54
3	Vendime të dhënë nga GJEDNJ	34
4	Ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ	20

1.1 Çështje të komunikuar dhe të përfaqësuara në GJEDNJ

Gjatë vitit 2025, janë komunikuar 31 çështje (të përfaqësuara nga 43 kërkesa), nga këto, 15 çështje kanë natyrë civile, 8 janë të natyrës penale, si dhe 8 çështje lidhen me shkarkimin nga detyra të kërkuarve në kuadër të procesit të vettingut.

Në 44 çështje, Avokatura e Shtetit ka depozituar pranë Gjykatës, komente dhe observime në lidhje me pranueshmërinë dhe meritat e çështjeve;

Në 7 çështje, janë depozituar komente për shpërblimin e drejtë:

Në 3 çështje, janë dorëzuar komente dhe informacion i kërkuar nga Gjykata.

Gjithashtu, për 1 çështje kundër Greqisë është vlerësuar të mos ndërhyhet, bazuar në parimin e reciprocitetit.

1.2 Vendime gjyqësore të dhëna nga GJEDNJ – 34 vendime për 44 kërkesa

Gjatë vitit 2025, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka dalë me 34 vendime² për Shqipërinë, nga të cilat:

- Në 12 vendime, janë pranuar kërkesat dhe janë konstatuar shkelje.

Konkretisht:

1. Ibrahim dhe të tjerë – 14/01/2025 – shkelje e Nenit 6 (e drejtë për një proces të rregullt ligjor, mungesa e aksesit në Gjykatën Kushtetuese)
2. Frroku – 04/02/2025 – shkelje e Nenit 6 (mungesa e arsytimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese)
3. Gëllçi – 25/02/2025 – shkelje e Nenit 5-3 (arsyetueshmëria e paraburgimit)
4. Fortuzi – 22/04/2025 – shkelje e Nenit 6 (tejzgjatje e proceseve gjyqësore dhe mungesë aksesit në Gjykatën Kushtetuese)
5. Jaupi – 29/04/2025 – shkelje e Nenit 6/1 aspekti penal (Pyetja e dëshmitarëve)
6. ARB dhe të tjerët – 27/05/2025 – shkelje e Nenit 6 dhe Nenit 13 (tejzgjatja e procesit dhe e drejta për një mjet efektiv juridik)
7. Kastriot Ismailaj dhe të tjerë – 08/07/2025 – shkelje e Nenit 6 (Gjykata e paanshme)

² 3 nga të cilat bëhen përfundimtar në shkurt dhe mars 2026.

8. Kroi dhe Noçka – 26/08/2025 – shkelje e Nenit 6 (Gjykata e paanshme)
9. Rarani dhe të tjerët – 14/10/2025 – shkelje e Nenit 6 (gjykim i drejtë-vendimi i arsyetuar dhe bazuar në prova)
10. Ilia – 15/07/2025 – shkelje e Nenit 6 (aksesi në gjykatë)
11. Lasku dhe të tjerët – 18/11/2025 – shkelje e Nenit 6 dhe Nenit 1 të Protokollit 1 (mbrojtja e pronës)
12. Selimi – 25/11/2025 – shkelje e Nenit 6 (vetting)

- **Në 16 vendime, Gjykata** i ka shpallur kërkesat e papranueshme:

1. Qiqi k Shqipërisë – 13/02/2025
2. Tafa k Shqipërisë – 27/02/2025
3. Fullani dhe të tjerët – 20/03/2025
4. Duhaxhiu k Shqipërisë – 2/05/2025
5. Petrela dhe të tjerë k Shqipërisë – 24/04/2025
6. Arginert Shpk k Shqipërisë – 05/06/2025
7. Broci k Shqipërisë – 12/06/2025
8. Lamaj k Shqipërisë – 12/06/2025
9. Kotherja k Shqipërisë – 09/09/2025
10. Çini dhe të tjerë k Shqipërisë – 16/10/2025
11. Malaj k Shqipërisë – 16/10/2025
12. Tom Ndreca k. Shqipërisë-16.9.2025
13. Hoxha k Shqipërisë – 9/10/2025
14. Marku k Shqipërisë – 16/10/2025
15. Zeneli k Shqipërisë – 11/12/2025
16. Kujxhia k Shqipërisë – 11/12/2025

Në 6 vendime Gjykata vendosi nxjerrjen e çështjeve jashtë listës së gjykimeve (“struck out of the list”), kryesisht për mungesë interesi për ndjekjen e çështjes ose për shkak se ka pranuar Deklaratat e zgjidhjes me pajtim të nënshkruar nga palët apo Deklaratat Unilaterale.

1. Xheka k Shqipërisë – 13/02/2025 → Nxjerrja nga lista për mungesë interesi nga kërkuesi
2. Zorba k Shqipërisë – 06/03/2025 → Nxjerrja nga lista-Zgjidhje me pajtim
3. Peshkopia dhe Talipi k Shqipërisë – 06/03/2025 → Nxjerrja nga lista-për mungesë interesi
4. Danushi k Shqipërisë – 3/04/2025 → Nxjerrja nga lista-zgjidhje me pajtim
5. Kaçorri k Shqipërisë – 10/07/2025 → Nxjerrja nga lista për shkak të mungesës së interesit nga kërkuesi
6. Pajova dhe Bajrami k Shqipërisë – 10/07/2025 → Nxjerrja nga lista për mungesë interesi dhe pjesërisht për një kërkuesë e papranueshme.

1.3 Kërkesa të pranuar nga GJEDNJ dhe shkeljet e konstatuara

- **Vendime për tejzgjatje procedurash/mungesë aksesi.**

Gjatë këtij vitit, kanë dalë **2 vendime**, “ARB dhe të tjerë k.Shqipërisë” dhe “Fortuzi k.Shqipërisë”, në të cilat Gjykata ka konstatuar problematika lidhur me tejzgjatjen e

procedurave gjyqësore, administrative apo ato të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore vendase, të cilat janë tashmë një praktikë e konsoliduar shkeljesh kundër Shqipërisë.

Miratimi i ndryshimeve ligjore të Kodit të Procedurës Civile në vitin 2017 (neni 399/1 e vijues të tij), i cili përshiu një kapitull për konstatimin e shkeljes së tejzgjatjes së procedurave dhe shpërblimin e drejtë për një shkelje të tillë, nuk po jep efektin e dëshiruar, për shkak të masave të marra për reformën në drejtësi (*Procesi i vettingut*). Mungesa e gjyqtarëve dhe mosmarrja e masave që t'i japin zgjidhje çështjes në themel nga gjyqësori (KLGJ), ka bërë që stoku i çështjeve në pritje për tu gjykuar të rritet në mënyrë të konsiderueshme dhe mjeti efektiv i parashikuar në Kodin e Procedurave Civile të mos jetë më efektiv.

Avokatura e Shtetit ka pranuar në shumë raste zgjidhjen me pajtim për shumë çështje me këtë problematikë, në mënyrë që mos të figurojnë si shkelje të Konventës, deri sa masat e marra nga institucionet publike, të japin efektet pozitive të dëshiruara.

Në mënyrë të veçantë në konstatimin e shkeljeve ka ndikuar disa here dhe vendimmarrja jo efektive e Gjykatës së Lartë e cila marrë disa vendime në të cilat ka vlerësuar se nuk ka shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm për shkak të vonesave sepse kjo ka ardhur si pasojë e mungesës në organikë të gjyqtarëve. GJEDNJ në vendimin “*Bara dhe Kola*”, nuk e mbështeti këtë “justifikim”, duke argumentuar që, pavarësisht zhvillimeve në gjyqësor, në çdo rast, barra për tejzgjatjen e proceseve tej një afati të arsyeshëm nuk mundet dot t'i lihet individit.

Kjo vendimmarrje e GJEDNJ, ka vijuar me vendimin “Arb dhe të tjerë k. Shqipërisë” i dalë në datën 27.05.2025, në të cilin Gjykata rikujtoi çështjen *Bara & Kola*, dhe theksoi se problematika e tejzgjatjes së procedurave tashmë është konstatuar edhe në vetë çështjet që lidhen me kompensimin për tejzgjatje.

Por në këtë vendim, Gjykata ka avancuar më tej në vlerësimin e saj, duke konsideruar si joefektiv, në rrethana të caktuara, nenin 399/1 të Kodit të Procedurës Civile.

Ky vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut duket se përbën një paralajmërim të qartë, duke vlerësuar se në mungesë të masave të shpejta dhe konkrete për përmirësimin e situatës, ky mekanizëm rrezikon të konsiderohet në mënyrë përfundimtare si joefektiv nga Gjykata. Një zhvillim i tillë do të kishte pasojë të drejtpërdrejta, duke ekspozuar Shqipërinë ndaj një vale të re aplikimesh dhe vendimesh për shkelje sistematike. Gjithësesi kohët e fundit Gjykata e Lartë duket se pas këtyre vendimeve të GJEDNJ-së e ka ndryshuar praktikën e saj dhe ka marrë disa vendime në përputhje me vendimmarrjen e GJEDNJ-së.

Masat e rekomanduara nga vet GJEDNJ, në vendimin datë 27.05.2025 *ARB k. Shqipërisë*:

- Plotësimi i vakancave në gjykata, veçanërisht në nivel apeli.
- Rritjen e burimeve njerëzore dhe materiale për kapërcimin e situatës.
- Zbatimin e strategjisë për uljen e vonesave dhe backlog-ut.
- Kërkohet rishikimi i mekanizmit të përshpjetimit dhe kompensimit, pasi ai nuk funksionon në praktikë dhe rrezikon të shtojë më tej ngarkesën në sistemin gjyqësor.
- Plotësimin urgjent të vakancave në gjykata, veçanërisht në nivel apeli;
- Rritjen e burimeve njerëzore dhe materiale;
- Zbatimin efektiv të strategjive për uljen e backlog-ut;
- Rishikimin e mekanizmit të përshpjetimit dhe kompensimit, i cili aktualisht rrezikon të rrisë më tej ngarkesën në sistemin gjyqësor.

Gjithashtu, sa i përket tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, GJEDNJ gjatë këtij viti ka dalë dhe me dy vendime, të cilat u zgjidhën me procedurat e zgjidhjes me pajtim të çështjeve, duke pranuar deklaratën e qeverisë:

Çështje të mbyllura me pajtim (jo shkelje): Zorba k Shqipërisë, datë 06.03.2025 dhe “Danushi k.Shqipërisë” datë 03.04.2025.

Rekomandimi i Avokaturës. Tejzgjatja e procedurave gjyqësore, administrative apo ato të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore vendase, janë tashmë një praktikë e konsoliduar shkeljesh kundër Shqipërisë. Miratimi i ndryshimeve ligjore të Kodit të Procedurës Civile, duke u përfshirë një kapitull për konstatimin e shkeljes së tejzgjatjes së procedurave dhe shpërblimin e drejtë për një shkelje të tillë, nuk po jep efektin e dëshiruar, për shkak të masave të marra për reformën në drejtësi. Është kjo arsyeja, që pranohet zgjidhja me pajtim për çështjet me këtë problematikë, në mënyrë që mos të figurojnë si shkelje të Konventës, për sa kohë masat e marra nga institucionet publike, të japin efektet pozitive të dëshiruara.

- Vendime për mungesë aksesit në Gjykatën Kushtetuese.

Gjatë vitit 2025, janë **marrë 3 vendime**, në të cilat GJEDNJ ka konstatuar shkelje të nenit 6/1 të Konventës, sa i takon mungesës së aksesit në Gjykatën Kushtetuese.

Këto vendime, “*Ibrahimi dhe të tjerë*” “*Ilia*” dhe “*Fortuzi*” konfirmojnë vijimësinë e praktikës së mëparshme të Gjykatës për këtë problematikë, sa i takon mohimit të aksesit në Gjykatën Kushtetuese dhe llogaritjes së gabuar të afatit kohor për paraqitjen e një ankese nga data e vendimit të Gjykatës së Lartë.

Rekomandimi i Avokaturës. Duke qenë se aksesit në Gjykatën Kushtetuese, sa i përket vlerësimit të kësaj të fundit të afatit 4 mujor për paraqitjen e kërkesës, është një shkelje e konsoliduar tashmë dhe e pranuar nga GJEDNJ, kemi rekomanduar, që çështjet e komunikuar me këtë problematikë të zgjidhen me pajtim, duke u marrë përsipër gjykimi në Gjykatën Kushtetuese dhe një dëmshpërblim simbolik sa i takon shkeljes. Por, nga Gjykata Kushtetuese nuk kemi pasur një qëndrim në lidhje me këto rekomandime ndaj dhe këtë vit GJEDNJ ka vijuar me konstatimin e shkeljeve sa i përket këtij aspekti. Në këtë drejtim dhe në kuadër të ekzekutimit të këtyre vendimeve, Avokatura e Shtetit ka dërguar pranë Gjykatës Kushtetuese, vendimet dhe gjetjet kryesore të tyre duke kërkuar që të mbahen në konsideratë nga Gjykata Kushtetuese në praktikën e saj.

- Vendime për mungesë arsytimi.

Gjatë vitit 2025, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka **marrë dy vendime** që evidentojnë problematikën e mungesës së arsytimit të vendimeve gjyqësore, në nivelin e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë. Këto çështje lidhen me të drejtën e garantuar nga neni 6§1 i Konventës, për një proces të rregullt ligjor.

Gjetjet kryesore nga këto vendime tregojnë se gjykatat kombëtare shpesh refuzojnë ankesa pa dhënë arsyet e plota të vendimmarrjeve të tyre, duke u mbështetur vetëm në rezultatet e votimit apo në formulime të përgjithshme.

-Në çështjen “*Frroku k. Shqipërisë*” GJEDNJ rrëzoi ankesat e tjera të kërkuarit por pranoi atë në lidhje me mungesën e një vendimi të arsytuar, duke konstatuar se “14. Çështja në fjalë nuk ndryshon nga ajo e *Meli dhe Sëinkles Family Breëers N.V. (citur më lart, § 76)*, ku konstatoi se fakti që ankuesve nuk u ishin dhënë arsyet përkatëse për pretendimet e tyre përbënin shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës. Në atë rast, vendimi i Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ankesën e ankuesve ishte gjithashtu i kufizuar në paraqitjen e rezultatit të votimit, por nuk u dha arsye për themelin e çështjes (shih paragrafin 7 më lart). Gjykata konsideroi se kërkuarit në atë çështje u lanë pa ndonjë arsyetim adekuat në lidhje me arsyet mbi të cilat Gjykata Kushtetuese kishte arritur në përfundimet e saj.

-Në çështjen “*Rarani k. Shqipërisë*”, Gjykata arriti në konkluzionin se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmbush standardet e një vendimi të arsyetuar dhe të bazuar në prova, duke cenuar të drejtën për një gjykim të drejtë në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës.

Konkretisht Gjykata konstatoi se, Gjykata e Lartë kishte cenuar parimin e vlerësimit të provave dhe kufijtë e kompetencës së saj, duke arritur në përfundime faktike të ndryshme nga ato të gjykatave më të ulëta, pa u mbështetur në prova konkrete dhe në kundërshtim me përmbajtjen e dosjes gjyqësore. Në veçanti, ajo kishte përmbysur në mënyrë arbitrare konstatimet faktike të gjykatave të faktit, pa shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme pse raporti i ekspertit gjyqësor, i pranuar nga dy gjykatat më të ulëta, duhej konsideruar i parëndësishëm apo i pasaktë. Sipas Gjykatës Evropiane, një qasje e tillë nuk përbënte thjesht interpretim të provave, por rivlerësim të pajustificuar të fakteve, në mungesë të provave të reja, duke bërë që Gjykata e Lartë të tejkalonte rolin e saj si gjykatë e ligjit dhe të ndërhynte në kompetencën që u takon gjykatave të faktit.

Rekomandimi i Avokaturës. Në lidhje me këto vendime, Avokatura e Shtetit ka përcjell për zbatim si dhe për ta pasur në vëmendje, në praktikën e tyre vendimin e GJEDNJ-së, organeve më të larta në sistemin e drejtësisë: Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Shkollës së Magjistraturës (kësaj të fundit për ta bërë pjesë të kurikulave të saj). Nuk ka pasur nevojë për marrjen e masave të tjera, duke qenë se thjesht është konstatuar mungesa e zbatimit të ligjit.

-Vendime që kanë të bëjnë me elementë të tjerë të procesit të rregullt ligjor

a. Gjykatë e paanshme / arbitraritet procedural

Vendime kyçe: Kroi & Noçka (26.09.2025), “Kastriot Ismailaj dhe të tjerë k. Shqipërisë” (08.07.2025)

Gjetjet kryesore:

Në çështjen *Kroi & Noçka*, GJEDNJ arriti në përfundimin që ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës (e drejta për një gjykatë të paanshme), duke qenë se tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, që më parë kishin marrë pjesë në të njëjtën çështje në Gjykatën e Lartë, nuk u tërhoqën nga shqyrtimi i kërkesës individuale kushtetuese. Kjo situatë, sipas GJEDNJ-së, krijoi një dyshim të arsyeshëm për mungesë paanshmërie, veçanërisht duke qenë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese u mor me vota të barabarta (3 pro, 3 kundër). Gjykata theksoi gjithashtu problemet strukturore me vonesat në plotësimin e vakancave në Gjykatën Kushtetuese, të cilat kontribuan që çështja të gjykohej nga një trupë e paplotë.

Në çështjen *Kastriot Ismailaj dhe të tjerë k. Shqipërisë*, Gjykata konstatoi se ekzistonin dyshime objektivist të justifikuara për paanshmërinë e gjyqtarit K.K., pasi ai kishte gjykuar më parë mbi të njëjtat çështje faktike dhe juridike. Gjykata theksoi se, edhe pse formalisht Gjykata e Lartë shqyrtoi vetëm pranueshmërinë e rekursit, në vendim ajo komentoi edhe mbi meritat e çështjes, duke forcuar perceptimin e mungesës së paanshmërisë. Kërkuesve nuk i është garantuar mundësia të kërkonin përjashtimin e gjyqtarit.

Rekomandimi i Avokaturës. Avokatura e Shtetit ka përcjell për zbatim si dhe për ta pasur në vëmendje, në praktikën e tyre vendimin e GJEDNJ-së, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Shkollës së Magjistraturës (kësaj të fundit për ta bërë pjesë të kurikulave të saj). Sa i përket masave individuale GJEDNJ ka orientuar se *rihapja ose rigjykimi i çështjes përbën, në parim, mjetin më të përshtatshëm për korrigjimin e shkeljeve të nenit 6*, veçanërisht kur shkelja lidhet me mungesën e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatave vendase. Nuk ka pasur nevojë për marrjen e masave të tjera të përgjithshme, duke qenë se thjesht është konstatuar mungesa e zbatimit të garancive ligjore për një gjykim të drejtë.

b. Mungesa e mbrojtjes efektive në procesin penal

Gjatë vitit 2025, në një rast GJEDNJ ka konstatuar shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3(d) në çështjen penale *Jaupi k. Shqipërisë* – E drejta për një proces të rregullt ligjor dhe pyetja e dëshmitarëve.

Në çështjen *Jaupi k. Shqipërisë*, Gjykata Evropiane, duke zbatuar standardet e konsoliduara të jurisprudencës së saj, lidhur me përdorimin e deklaratave të dëshmitarëve vlerësoi se deklaratimet e dëshmitarëve B.H. dhe R.B., të dhëna në fazën hetimore, kishin qenë vendimtare për dënimin e kërkuesit për vrasje të mbetur në tentativë, ndryshe nga vlerësimi i bërë për dënimin për vrasje.

Duke zbatuar testin e përgjithshëm të drejtësisë së procesit sipas jurisprudencës së saj, Gjykata konstatoi mungesën e faktorëve të mjaftueshëm kundërbalancues: gjykatat vendase nuk ushtruan kontroll mbi deklaratimet e paverifikuara, nuk dispononin prova të tjera të forta fajësie dhe nuk morën masa procedurale për të kompensuar pamundësinë e mbrojtjes për të pyetur dëshmitarët drejtpërdrejt. Veçanërisht, nuk u trajtua argumenti thelbësor i mbrojtjes lidhur me mospërputhjen kohore dhe gjeografike të deklaratimeve të dëshmitarëve, ndërkohë që provat mbështetëse reduktoheshin në dyshime subjektive. Për më tepër, deklaratimet ishin marrë në mungesë të palëve, pa mundësi kundërshtimi dhe pa regjistrim audioviziv, duke i privuar gjykatat dhe mbrojtjen nga çdo vlerësim i drejtpërdrejtë i besueshmërisë së dëshmitarëve. Në këto rrethana, Gjykata arriti në përfundimin se procesi penal, në këtë pjesë, nuk kishte qenë i drejtë dhe konstatoi shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3(d) të Konventës.

- **Vendime për shkelje të së drejtës së pronës, Neni 1 i Protokollit 1.**

Gjatë vitit 2025, Gjykata ka dalë me një vendime për shkelje të së drejtës së pronës, Neni 1 të Protokollit 1 të Konventës, Vendimi "*Lasku dhe të tjerë k. Shqipërisë*".

Së pari, vlen të theksohet se në çështjen *Lasku dhe të tjerët*, shkelja e konstatuar nga Gjykata e nenit 1 të Protokollit nr. 1, buron nga cenimi i parimit të sigurisë juridike, si element thelbësor i nenit 6 § 1 të Konventës. Sipas GJEDNJ-së, ndërhyrjet e vazhdueshme dhe kontradiktore të gjykatave vendase në një situatë juridike tashmë të konsoliduar kanë krijuar pasiguri mbi titullin e pronës, duke minuar besimin legjitim të kërkuesve në sigurinë e vendimeve gjyqësore përfundimtare. Kjo mungesë sigurie juridike ka çuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë, edhe në cenimin e së drejtës së pronës, pasi kërkuesit janë privuar nga ushtrimi efektiv i të drejtave të tyre pronësore si pasojë e rihapjes ose rishqyrtimit arbitrar të çështjes në nivel kombëtar.

Në vendimin "*Lasku dhe të tjerë k. Shqipërisë*", Gjykata vlerësoi konkretisht se kjo çështje paraqet problematika të ngjashme me ato në çështjen "*Gaba k. Shqipërisë*", ku u konstatua një shkelje e të drejtës së kërkuesit për gjykim të drejtë, sipas nenit 6 § 1 për anulimin e një vendimi të formës së prerë të komisionit për rikthimin e pronave pa rrethana substanciale dhe bindëse. Në të njëjtën linjë dhe në rastin konkret Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut arriti në përfundimin se anulimi i vendimeve të Komisionit rreth 10 vjet pasi ato kishin marrë formë të prerë, nuk mbështetej në arsye përmbajtjesore dhe bindëse (substantial and compelling reasons) pasi: (i) Gjykatat vendase nuk kishin dhënë shpjegime të mjaftueshme se toka gjendej në një zonë turistike; (ii) Nuk kishte dyshime për vërtetësinë e dokumenteve ku mbështetej pretendimi pronësor i ankuesve dhe as për mirëbesimin e tyre; (iii) Toka në fjalë në çdo rast iu shit një pale private në vitin 2014.

Ndaj Gjykata konkludoi se anulimi i vendimeve të formës së prerë të Komisionit pa rrethana substanciale dhe bindëse, në një mënyrë që nuk ishte në pajtim me parimin e sigurisë juridike, i zhgënjeu kërkuesit për sa i përket vendimeve të kthimit të pronës, dhe i privuan ata nga mundësia për të zbatuar titujt e tyre të pronësisë ndaj pronës. Për këto arsye, ishte shkelur Neni 6§1 dhe Neni 1 të Protokollit nr. nr. 1 të Konventës.

Rekomandimi i Avokaturës: Nga ana e Avokaturës së Shtetit, vendimi *Lasku dhe të tjerë k. Shqipërisë*, i është dërguar për ekzekutim financiar Ministrisë së Financave për pjesën e shpërblimit të drejtë. Gjithashtu, Avokatura e Shtetit ka bërë një analizë të thelluar të këtij

vendimi pasi ekzekutimi i këtij vendimi paraqet sfida të veçanta, duke qenë se Gjykata Evropiane, përtej dhënies së dëmshtëpërlimit monetar, ka orientuar disa forma alternative ekzekutimi, duke theksuar parimin e restitutio in integrum. Konkretisht, Gjykata ka vlerësuar se, në parim, kërkesit duhet të vendosen sa më afër të jetë e mundur në situatën që do të kishin pasur nëse shkelja e nenit 1 të Protokollit nr. 1, përmes rikthimit të titullit dhe të pronës, përfshirë edhe rihapjen e procedurave vendase, nëse kjo është e zbatueshme. Megjithatë, duke marrë parasysh rrethanat konkrete të çështjes, Gjykata ka pranuar se restitutio in integrum mund të mos jetë e realizueshme në praktikë; në këtë rast, shteti është i detyruar të sigurojë kompensim monetar adekuat sipas vlerës aktuale të pronës, ose dhënien e një prone të krahasueshme me vlerë të barabartë, duke e lënë zgjedhjen e mjetit konkret të ekzekutimit në diskrecionin e autoriteteve vendase, por brenda kufijve të standardeve të vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës.

Avokatura e Shtetit ka përcjell vendimin e GJEDNJ-së për zbatim në institucionet përgjegjëse së bashku me orientimet e GJEDNJ-së. Gjithashtu, në kuadër të masave të përgjithshme, një analizë e thelluar do të dërgohet Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Shkollës së Magjistraturës.

1.4 Kërkesa të zgjidhura me marrëveshje miqësore

Gjatë vitit 2025, janë marrë 2 vendime, për nxjerrjen e çështjeve nga lista e shqyrtimit, duke qenë se Gjykata ka pranuar zgjidhjen me pajtim të nënshkruar nga palët ose deklaratën Unilaterale të Qeverisë, *Zorba k. Shqipërisë* dhe *Danushi k. Shqipërisë*.

Të gjitha çështjet, të cilat janë zgjidhur me pajtim kanë paraqitur problematika të ngjashme, që kanë të bëjë me tejzgjatjen e procedurave gjyqësore vendase, gjatë proceseve gjyqësore ose mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, në shkelje të Nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për këtë kategori çështjesh tashmë ka një praktikë të konsoliduar nga Gjykata, duke i klasifikuar ato në çështjet “*Luli dhe të tjerë k. Shqipërisë*”, kërkesa nr.64480/09, dhe “*Mishgjoni k. Shqipërisë*”, kërkesa nr.18381/05, në të cilat Republika e Shqipërisë është gjendur në shkelje për tejzgjatjen e procedurave gjyqësore dhe administrative. Për këtë shkak, Gjykata ka ofruar zgjidhjen e tyre me pajtim, duke propozuar dhe shumat përkatëse për çdo çështje. Shumat e propozuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë në përputhje me ato për shpërblimin e drejtë të parashikuara nga legjislacioni ynë procedural (Nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile), përsa i takon tejzgjatjes së procedurave gjyqësore.

Refuzimi i tyre do rriste faturën financiare për secilin prej proceseve të njoftuara. Veç kësaj, vlerësohet se konstatimi nga GJEDNJ i shkeljeve për këto çështje do të na ekspozonte përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, në lidhje me shkeljet e nenit 6/1 dhe 13 të Konventës, sa i takon tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, duke qenë se tashmë Komiteti po ndjek me procedurë të përshpejtuar ekzekutimin e vendimit “*Luli dhe të tjerë k. Shqipërisë*” dhe masat e marra nga Qeveria shqiptare në lidhje me këtë problematikë.

Për arsyet e paraqitura më lart është vlerësuar dhe pranuar zgjidhja e tyre me pajtim dhe, në vijim rekomandohet që çështje të tilla të zgjidhen me pajtim.

1.5 Vendime lidhur me çështjet e vettingut

Gjatë këtij viti GJEDNJ ka shqyrtuar 8 kërkesa dhe ka dalë me 6 vendime që kanë të bëjnë me procesin e rivlerësimit kalimtar (“vetting”) të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Shumica e këtyre kërkesave në përputhje tashmë me praktikën e konsoliduar të Gjykatës për këtë proces janë shpallur të papranueshme (përfshirë çështje si *Fullani*, *Broci*, *Zeneli* etj.). Vendimi Selimi k. Shqipërisë është i vetmi vendim që GJEDNJ ka konstatuar shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me komponentin e vlerësimit të figurës gjatë procesit të vettingut.

Në vendimin **Selimi k. Shqipërisë** (nr. 37896/19, 25.11.2025), Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, duke konstatuar se gjatë procesit të vettingut, kërkuesi nuk u informua në mënyrë të mjaftueshme për akuzat, nuk pati mundësi reale për t'i kundërshtuar provat e padeklaruar, dhe organet e vettingut përdorën prezumime faktike pa arsyetim, duke mos marrë masa të balancuara për të mbrojtur të drejtat procedurale të kërkuesit. Gjykata theksoi se këto mangësi cenonin thelbin e të drejtës për një proces të rregullt por nuk konstatoi shkelje autonome të nenit 8, pasi gjetjet nën nenin 6 mbulonin aspektet e pretenduara të jetës private.

Konkretisht GJEDNJ konstatoi shkelje këto elementë të procedurës:

- *Mungesa e informacionit të mjaftueshëm për akuzat:* Kërkuesi nuk u informua në mënyrë të detajuar për akuzat ndaj tij dhe nuk pati mundësi reale për t'i kundërshtuar ato. Organet e vettingut u mbështetën në prova të pakomunikuara (nga DSIK, ONM dhe autoritete të huaja).
- *Përdorimi i prezumimeve faktike:* Vendimi u bazua në supozime për kontaktet e pretenduara të kërkuesit me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe lidhjen e tij përmes përdorimit të një automjeti, pa prova konkrete ose arsyetim të qartë.
- *Mungesa e masave balancuese:* Nuk u ofruan forma të sigurta për të balancuar mungesën e informacionit dhe transparencës, si redaktim i materialeve sekrete ose përmbledhje.
- *Akuzat për korrupsion dhe ndërhyrje të paligjshme (2014–2015):* Kërkuesi mori vetëm versione të redaktuara dhe të përgjithshme të materialeve, pa elementet kryesore faktike. Materialet kryesore nga burime të huaja nuk i u komunikuan.
- *Kontaktet e supozuara me A.I.:* Akuzat ishin të paqarta dhe nuk përmbanin prova konkrete (data, vende, rrethana). Barrë disproporcionale për kërkuesin për të kundërshtuar pohime të paqarta.
- *Përdorimi i automjetit të A.S.:* Organet e vettingut bënë prezumime faktike se kërkuesi duhej të dinte lidhjen e tij me A.I., pa prova dhe pa arsyetim. Arsyeve të kërkuesit për përdorim sporadik të mjetit nuk iu dha përgjigje.
- *Pamundësia e reagimit ndaj argumenteve vendimtare:* Kërkuesi nuk pati mundësi reale për të sfiduar provat e padeklaruar apo për të dhënë versionin e tij në mënyrë të informuar.

Konkluzioni: Procesi i vettingut, veçanërisht në komponentin e “figurës” së kërkuesit, çënoi thelbin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Në lidhje me rihapjen e procesit. Gjykata nuk ka kërkuar specifikisht për masa të tjera individuale si rihapja e procesit.

1.6 Kërkesa të shpallura të papranueshme

Gjatë vitit 2025, Gjykata ka dalë me **16 vendime papranueshmërie**. Nga këto vendime, na lejoni të veçojmë:

a. Vendimet në lidhje me çështjet e Vettingut.

1. Në vendimin “**Zeneli k. Shqipërisë**”, në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 8 të Konventës, Gjykata ndër të tjera u shpreh se shkarkimi i kërkuesit përbënte ndërhyrje në jetën private sipas nenit 8, por u vlerësua se kjo ndërhyrje ishte e ligjshme dhe se nuk u konstatua asnjë cenim i standardeve procedurale. Gjykata theksoi se mospërputhjet dhe mospasqyrimi i burimeve financiare nga aplikanti – përfshirë një mungesë të konsiderueshme fondesh për blerjen e banesave në vitet 1999 dhe 2002 – ishin të provuara dhe justifikonin konkluzionet e organeve të vettingut.

Gjykata pranoi se deklaratat e vitit 2007 ishin përdorur thjesht si provë plotësuese dhe jo si bazë shkarkimi, në përputhje me jurisprudencën e mëparshme (Thanza, Nikëhasani). Kërkuesi nuk sollti prova që të rrëzonin vlerësimet faktike të organeve vendase dhe pretendimet për arbitraritet u konsideruan të pabazuara. GJEDNJ gjeti se organet e vetingut kishin kryer një analizë të kujdesshme, proporcionaliteti ishte respektuar dhe standardet e integritetit për gjyqtarët kërkonin vlerësim të rreptë të burimeve financiare. Në mungesë të ndonjë arsyeje të fortë për të zëvendësuar konkluzionet e gjykatave vendase, kërkesa u shpall në tërësi e papranueshme dhe e pambështetur.

2. Në vendimin “**Artan Broci k. Shqipërisë**”, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut shpalli ankesën e kërkuesit të papranueshme si të pabazuar (neni 35 §§ 3(a) dhe 4). Sa i përket pretendimeve nën nenin 6, Gjykata vlerësoi se aplikanti nuk kishte paraqitur prova konkrete që të justifikonin dyshime mbi paanshmërinë e gjyqtarit; episodet e përmendura (vota e vitit 2006 dhe diskutimi i vitit 2014) nuk mund të konsideroheshin të mjaftueshme për të provuar ndikim mbi vendimet gjyqësore. Gjykata theksoi se pa elemente të tjera kontekstuale, çdo pretendim për armiqësi personale apo qëllime hakmarrëse nuk mund të sfidojë prezumimin e paanshmërisë së gjyqtarëve, që mbetet i vlefshëm derisa të provohet e kundërta.

Sa i përket nenit 8 të Konventës, Gjykata vlerësoi se argumentet e aplikantit mbi paligjshmërinë e masave dhe mungesën e qëllimit legjitim ishin të ngjashme me ato të refuzuara në vendime të mëparshme, përfshirë *Thanza v. Albania*. Autoritetet kombëtare kishin kryer një analizë të kujdesshme të akteve, kishin respektuar standardet e Konventës dhe kishin balancuar në mënyrë të drejtë interesin publik me të drejtat individuale. Në këto kushte, masa e shkarkimit të aplikantit ishte proporcionale dhe e justifikuar, dhe nuk përbënte shkelje të nenit 8 të Konventës. Gjykata konfirmoi se nëse gjykatat vendase kanë shqyrtuar me kujdes faktet, kanë zbatuar standardet përkatëse të të drejtave të njeriut në përputhje me Konventën dhe praktikën e Gjykatës dhe kanë balancuar në mënyrë të drejtë interesin individual me interesin publik në çështje, Gjykata kërkon arsye të forta për të zëvendësuar vlerësimin e saj me atë të gjykatave vendase.

3. Në vendimin “**Malaj k. Shqipërisë**”, Gjykata në lidhje me nenin 6/1, arriti në përfundimin se: *“Gjykata nuk sheh asnjë arsye për të arritur në përfundimin, se refuzimi i KPA-së për të urdhëruar një tjetër ekspertizë ka shkelur parimin e zhvillimit kontradiktor të procedurës (shih paragrafin 9 më sipër). Sa i takon pretendimit të ankuesit për pamundësinë për të marrë në pyetje ekspertët financiarë të KPA-së dhe për mungesë kohe të mjaftueshme përgatitjeje të mbrojtjes në lidhje me analizën financiare të KPA-së, Gjykata vëren se ankuesi ka pasur mundësinë t’i ngrinte këto çështje gjatë procedurave vendase dhe ato janë vlerësuar në mënyrë të duhur. Vlerësimi financiar është bazuar në të njëjtat prova të shqyrtuara nga KPK, dhe ankuesit i është dhënë një mundësi e përshtatshme për të paraqitur argumentet e tij në mënyrë efektive. Gjykata nuk gjen asnjë arbitraritet; prandaj, kjo pjesë e ankesës është e papranueshme si qartazi e pabazuar.*

Në lidhje me nenin 8 të Konventës, ndër të tjera Gjykata ka theksuar se, kur gjykatat vendase kanë shqyrtuar me kujdes faktet, kanë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme standardet përkatëse të të drejtave të njeriut në përputhje me Konventën dhe jurisprudencën e saj, si dhe kanë bërë një balancim të përshtatshëm midis interesave individuale dhe interesit publik në një çështje të caktuar, Gjykata do të kërkonte arsye të forta për të zëvendësuar vlerësimin e saj me atë të gjykatave vendase (shih *Halet kundër Luksemburgut [GC]*, nr. 21884/18, § 161, 14 shkurt 2023, dhe *Thanza*, e cituar më sipër, § 158). Prandaj, shkarkimi i ankuesit nga detyra ka qenë proporcional me qëllimet legjitime, në rrethanat e çështjes.

4. Në vendimin “**Fullani dhe të tjerë kundër Shqipërisë**” (Muskaj, Qirjako), Gjykata Evropiane në përputhje me praktikën e saj të mëparshme (*Bala v. Albania*, nr. 21141/20, 9 prill 2024) konstatoi se ndalimi 15-vjeçar për t’u emëruar në poste gjyqësore pas përfundimit të procesit të vettingut nuk kishte shkaktuar dëme të mjaftueshme ndaj jetës private të aplikantëve sipas nenit 8 të Konventës, pasi ata kishin zgjedhur vetë të mos pranonin emërimet si gjyqtarë të

apelit dhe kishin nisur praktikën private, duke humbur statusin e magjistratit. Nuk kishte prova se ndalimi kishte dëmtuar reputacionin e tyre në mënyrë serioze ose se kishte ndikuar në jetën e tyre private përtej kufijve të lejuar nga Konventa. Përveç ndalimit të aksesit në poste të caktuara në sistemin e drejtësisë, nuk kishte pengesa konkrete të provuara për pozita të tjera të hapura për ish-gjyqtarët ose profesionistët e tjerë ligjorë. Për këto arsye, Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme dhe nuk konstatoi shkelje të Konventës.

Ndalimi nuk arrin nivelin e rëndësisë që kërkohet për mbrojtje sipas nenit 8, pasi pasojat negative nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me jetën private. Si rrjedhojë, masat nuk konsiderohen të arbitrare ose disproporcionale, duke qenë në përputhje me praktikën e mëparshme të Gjykatës për raste të ngjashme.

5. Në vendimin “**Ndreca k. Shqipërisë**” kërkuesi ankohej lidhur me shkarkimin e tij nga detyra e prokurorit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar (vettingut), duke pretenduar se shkarkimi i tij përbënte ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën për respektimin e jetës private, në kuptim të nenit 8 të Konventës.

Gjykata konstatoi se shkarkimi nga detyra përbënte ndërhyrje në të drejtën për jetën private të kërkuesit, por vlerësoi se kjo ndërhyrje ishte e parashikuar nga ligji, ndiqte një qëllim legjitim dhe ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, në përputhje me standardet e vendosura në praktikën e saj të mëparshme, veçanërisht *Thanza k. Shqipërisë* dhe *Xhoxhaj k. Shqipërisë*. Gjykata nuk konstatoi mangësi serioze procedurale në procesin vendimmarrës në nivel kombëtar dhe çmoi se interpretimi i ligjit vendas nga KPA ishte brenda kufijve të arsyeshmërisë dhe jo arbitrar. Parregullsitë e konstatuara në vlerësimin e pasurisë (përfshirë banesën në Golem dhe garazhin në Tiranë), si dhe deklaratimet e pasakta apo kontradiktore, u vlerësuan si të mjaftueshme për të justifikuar masën e shkarkimit, duke pasur parasysh pozicionin dhe standardet e larta të integritetit që kërkohen nga një prokuror. Në këto rrethana, Gjykata arriti në përfundimin se masa e shkarkimit nuk ishte joproporcionale dhe shpalli ankesën sipas nenit 8 të Konventës qartazi të pabazuar, duke e deklaruar kërkesën të papranueshme në bazë të nenit 35 §§ 3(a) dhe 4 të Konventës.

Vlen për tu theksuar, se në të gjitha vendimet Gjykata ka mbajtur qendrimin në vijim të gjetjeve në vendimet e saj për Vettingun, që përbëjnë praktikë të konsoliduar tashmë, “Sevdari k. Shqipërisë”, “Nikëhasani k. Shqipërisë”, “Xhoxhaj k. Shqipërisë”, “Thanza k. Shqipërisë” “Bala k Shqipërsë”.

- Vendime të tjera papranueshmërie me rëndësi për praktikën gjyqësore

Në vendimin “**Kotherja k. Shqipërisë**“, GJEDNJ, në përfundim të shqyrtimit vendosi, të shpallë kërkesën të papranueshme, si të pabazuar, referuar nenit 34/3 (a) dhe 4 të Konventës. Gjykata konstatoi se fakti që Gjykata e Lartë zbatoi rregullat e reja mbi procedurën për seancat publike edhe për çështjet në zhvillim nuk ishte, në vetvete, në kundërshtim me garancitë e dhëna nga neni 6 § 1 i Konventës. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se rekursi i kërkueses u shpall i papranueshëm vetëm pas shqyrtimit efektiv të pretendimeve të saj në themel dhe ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për vendimin e saj. Gjykata e Lartë arsyetoi se gjykatat më të ulëta kishin zbatuar si ligjin procedural, ashtu edhe atë material, në mënyrë të drejtë dhe kishin shqyrtuar plotësisht argumentet e ngritura nga kërkuesja në rekursin e saj.

Rekomandimi i Avokaturës së Shtetit. Kjo vendimmartje dhe ky qendrim i Gjykatës paraqet rëndësi në konfirmimin e ndryshimeve që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile në 2016, sa i takon gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe praktikës së kësaj të fundit, në lidhje me qendrimin e saj për gjykimin e çështjeve për të cilat ishte vendosur më parë kalimi në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi.

Në vendimin “**Nikolin Kujxhia dhe të tjerë k. Shqipërisë**“, në lidhje me ankesën e kërkuesve për moszbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në favor të tyre, që lidhen me lirinim

e një parcele toke dhe ndërtesave mbi të, Gjykata duke konstatuar se çështja përkatëse ishte ende në shqyrtim para Gjykatës së Lartë, arriti në përfundimin se vonesa e pretenduar në ekzekutim nuk mund t'i atribuohet autoriteteve vendase në mënyrë që të përbënte shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës ose të Nenit 1 të Protokollit nr. 1.

Për rrjedhojë, Gjykata e shpalli kërkesën qartazi të pabazuar dhe e deklaroi atë të papranueshme, në përputhje me nenin 35 §§ 3(a) dhe 4 të Konventës.

Vlerësimi/Rekomandimi i Avokaturës së Shtetit. Avokatura e Shtetit ka vijuar me procedurat e ekzekutimit të këtij vendimi, duke e dërguar për përkthim pranë Ministrisë së Drejtësisë, dhe më pas duke e shpërndarë në organet e drejtësisë dhe Gjykatat më të larta, me qëllim për ta konsideruar si praktikë të konsoliduar të GJEDNJ-së në lidhje me procesin e ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë.

2. EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË GJEDNJ-SË GJATË PERIUDHËS JANAR-DHJETOR 2025

2.1 Përmbledhje ekzekutive

Avokatura e Shtetit gjatë kësaj periudhe ka fokusuar punën, dhe në një nga drejtimit kryesore të objektit të veprimtarisë së saj, që lidhet me procesin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në këtë kontekst, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025, Avokatura e Shtetit ka iniciuar procedurat për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, si dhe ka vijuar të raportojë pranë Komitetit të Ministrave për masat e përgjithshme dhe individuale të ndërmarra nga autoritetet shqiptare në kuadër të procesit të ekzekutimit të këtyre vendimeve.

Në vitin 2025, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka dërguar në Komitetin e Ministrave 13 çështje kundër Shqipërisë për mbikëqyrjen e ekzekutimit të tyre. Shkeljet e konstatuara nga Gjykata në vitin 2025 dhe aspektet që ndiqen për monitorim nga Komiteti i Ministrave lidhen, ndër të tjera, me dështimin e tejzgjatur për të ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë që rikthente titullin e pronësisë mbi një parcelë toke, anulimin e vendimeve përfundimtare për kthimin e pronës pa arsye bindëse, mosdëgjimin e dëshmitarëve në proceset penale, zgjatjen e procedimeve dhe mungesën e një mjeti juridik efektiv në këtë drejtim.

2.2 Çështjet në monitorim

Aktualisht janë 63 çështje për monitorim nga Komiteti i Ministrave, nga të cilat 7 ndiqen me procedurë të përshpejtuar dhe të tjerat me procedurë standarde.

2.3 Planet dhe raportet e veprimit

Gjatë vitit 2025, Avokatura e Shtetit ka dërguar 27 Plane/Raporte Veprimi dhe komunikime/informacione të përditësuar lidhur me çështjet në ekzekutim.

2.4 Arritjet kryesore në vitin 2025

Komiteti i Ministrave mbylli monitorimin për 8 çështje në vitin 2025, duke përfshirë dy çështje kryesore “leading cases” nën mbikëqyrjen standarde. “Ana VEIZI dhe të tjerët k. Shqipërisë” - kërkesa nr. 16191/13; “Rinaldo Myrtaj dhe të tjerët” k. Shqipërisë - kërkesa nr. 70656/17; “Kola k. Shqipërisë - kërkesa nr. 61445/12; “Gëllçi k. Shqipërisë” kërkesa nr. 15468/23; “Papakostandini k. Shqipërisë - kërkesa nr. 7568/08; “Pinari k. Shqipërisë - kërkesa nr.32893/16; “Besnik Cani k. Shqipërisë - kërkesa nr. 37474/20; “Spahiu dhe të tjerë k. Shqipërisë” - kërkesa nr. 79452/17.

Ndër çështjet më të rëndësishme veçojmë çështjen “Cani k. Shqipërisë”, që ka të bëjë me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe *Veizi, Deda, Myrtaj* që ishin të hapura

për monitorim për më shumë se 8 vitesh, si dhe çështja “Gëllçi K Shqipërisë”, që ka të bëjë me mos dhënien e arsyeve të duhura dhe të mjaftueshme nga gjykatat vendase për të justifikuar privimin e lirisë së kërkuesit, sa i përket periudhës së paraburgimit.

2.5 Çështjet e mbyllura nga Komiteti i Ministrave të KiE-së

Gjatë vitit 2025, pas shqyrtimit të masave të përgjithshme dhe atyre individuale të ndërmarra nga autoritetet shqiptare, Komiteti i Ministrave mbylli monitorimin për 8 çështjet si vijon: “Ana Veizi dhe të tjerët k. Shqipërisë - kërkesa nr.16191/13”; “Rinaldo Myrtaj dhe të tjerët. k. Shqipërisë - kërkesa nr.70656/17”; “Kola k. Shqipërisë - kërkesa nr. 61445/12”; “Gëllçi k. Shqipërisë - kërkesa nr.15468/23”; “Papakostandini k. Shqipërisë - kërkesa nr.7568/08”; “Pinari k. Shqipërisë - kërkesa nr.32893/16; “Besnik Cani k. Shqipërisë - kërkesa nr. 37474/20”; “Spahiu dhe të tjerë k. Shqipërisë - kërkesa nr.79452/17”.

2.6 Pagesa e shpërblimit të drejtë

Gjatë vitit 2025, janë ndjekur me Ministrinë e Financave dhe Këshillin e Ministrave (në rastet e parashikuara nga ligji) procedurat për ekzekutimin e shpërblimit të drejtë për 20 vendimet si më poshtë:

1. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Ndrekaj Shpk kundër Shqipërisë”
 2. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Shkjezi kundër Shqipërisë”
 3. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Sovjani kundër Shqipërisë”
 4. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Dobrozi kundër Shqipërisë”
 5. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Maho kundër Shqipërisë”
 6. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Gëllçi kundër Shqipërisë”
 7. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Zorba kundër Shqipërisë”
 8. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Rrapo Danushi dhe të Tjerët kundër Shqipërisë”
 9. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Gaba kundër Shqipërisë”
 10. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Ilia kundër Shqipërisë”
 11. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Jaupi kundër Shqipërisë”
 12. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Ramaj kundër Shqipërisë”
 13. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Meli dhe Swinkels family Brewers N.V kundër Shqipërisë
 14. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “ARB Shpk dhe të tjerë kundër Shqipërisë”
 15. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Ibrahimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”
 16. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Rarani dhe të tjerë kundër Shqipërisë”
 17. Ekzekutimi i Vendimit të GJEDNJ “Ismailaj dhe të tjerë kundër Shqipërisë”
- Vendimet e mëposhtme janë ndjekur gjatë vitit 2026 pasi kanë qenë brenda afateve të përcaktuara nga GJEDNJ.
18. “Lasku kundër Shqipërisë”
 19. “Kroi dhe Nocka kundër Shqipërisë”
 20. “Selimi kundër Shqipërisë”

- 2.7 Botimi në Fletoren Zyrtare dhe masa të tjera ndërgjegjëse

Të gjitha vendimet e GJEDNJ-së që janë konstatuar shkelje janë botuar në Fletore Zyrtare, në respektim të neneve 44 dhe 46 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjithashtu sa i përket ekzekutimit të masave individuale vlen të theksohet se gjatë vitit 2025 ka pasur disa grupe vendimesh që përveç masave që kanë të bëjnë me pagesën e shpërblimit të

drejtë, kanë kërkuar dhe ndërmarrjen e masave të tjera individuale. Të gjitha këto vendime iu janë dërguar gjykatave respektive për tu pasur në konsideratë, në rast se nga kërkuesit respektiv do të kërkohej rihapja e procedurave të brendshme dhe janë në ndjekje me institucionet respektive.

Sa i përket masave të përgjithshme, theksojmë se nuk ka qenë i nevojshëm, ndërmarrja e masave ligjore për të adresuar shkeljet e konstatuara nga Gjykata, pasi shumica e shkeljeve ka rezultuar nga mangësitë në zbatimin e ligjit dhe jo si rezultat i mungesës së tij. Për këtë arsye, në kuadër të masave të përgjithshme, për të rritur njohuritë dhe ndërgjegjësimin lidhur me vendimet dhe konstatimet e Gjykatës, të gjitha vendimet u janë përcjellë institucioneve respektive. Avokatura e Shtetit ka përgatitur një përmbledhje të gjetjeve kryesore të Gjykatës në këto vendime dhe ua ka përcjellë institucioneve respektive.

3. RAPORTIMET PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE TË GJEDNJ-SË NË KOMITETIN E MINISTRAVE TË KËSHILLIT TË EVROPËS

3.1 Vendime, ekzekutimi i të cilave ndiqet me procedurë të përshpejtuar

Gjatë vitit 2025, Avokatura e Shtetit, ka informuar në mënyrë të vazhdueshme Komitetin e Ministrave në lidhje me ekzekutimin e masave individuale dhe të përgjithshme për 6 vendime që ndiqen me procedurë të përshpejtuar me GJEDNJ respektivisht “Luli dhe të tjerë k. Shqipërisë”, “Strazimiri k. Shqipërisë”, “Sharxhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, “X dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, “Nika k. Shqipërisë” dhe “Durdaj k. Shqipërisë”.

- “Strazimiri k. Shqipërisë”

“Strazimiri k. Shqipërisë”. Në vendimin “Strazimiri k. Shqipërisë”, Gjykata ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës për shkak të kushteve të burgimit të kërkuesit dhe trajtimit jo të përshtatshëm mjekësor në Spitalin e Burgut, si dhe shkelje të nenit 5 § 1 dhe nenit 5 § 4 të Konventës, për shkak të dështimit të Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar brenda kohës së arsyeshme ankesën e kërkuesit të 11 janarit 2016.

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Avokatura e Shtetit gjatë vitit 2025, ka informuar në mënyrë të vazhdueshme Komitetin e Ministrave në lidhje me ekzekutimin e masave individuale dhe të përgjithshme për vendimin “Strazimiri k. Shqipërisë”.

Në kuadër të zbatimit të këtij vendimi janë dërguar informacione të përditësuara në Komitetin e Ministrave të KiE në janar dhjetor 2025, ku është informuar mbi masat e ndërmarra nga autoritetet tona për ekzekutimin e këtij vendimi.

Në lidhje me masat individuale, Komiteti i Ministrave është informuar nga autoritetet shqiptare e mbi gjendjen shëndetësore të kërkuesit, rivlerësimin e masës “mjekim i detyruar” nga Gjykata, si dhe planin individual të trajtimit të kërkuesit, në Institucionin Special të Lezhës.

Në lidhje me masat e përgjithshme është raportuar mbi:

(i) Masat e marra për të reduktuar mbipopullimin e Institucionit Special të Lezhës, i cili është evidentuar nga Komiteti i Ministrave si çështje shumë problematike ;

(ii) Planet e Ministrisë së Shëndetësisë për ndërtimin dhe bërjen funksional të një institucioni të posaçëm mjekësor, lidhur me akomodimin dhe trajtimin e të personave me masë mjekësore “Mjekim i Detyruar”;

(iii) Përmirësimin e kujdesit dhe kushteve të personave me masë mjekësore “Mjekim i Detyruar” dhe trajtimin ambulator të tyre.

Mbledhja e fundit e Komitetit të Ministrave: Në datat, 4-6 mars 2025(DH, Komiteti i Ministrave ka shqyrtuar masat individuale dhe masat të përgjithshme të ndërmarra nga autoritetet shqiptare për ekzekutimin e këtij vendimi.

Gjetjet dhe rekomandimet kryesore: (i) Komiteti theksoi se rishikimi i nevojës për mbajtjen e kërkuarit nuk kryhet gjithmonë një herë në vit, si kërkohet nga ligji vendas, dhe i ftoi autoritetet të sigurojnë që rishikimi të kryhet çdo vit, me pjesëmarrjen direkte ose përfaqësimin e aplikantit. (ii) Mbiipopullimi dhe kushtet në Institucionin Special të Lezhës – Komiteti shprehu shqetësim të madh për nivelin e lartë të mbiipopullimit, edhe pas disa masave afatshkurtra. Autoritetet u ftuan të shtojnë përpjekjet për të zgjidhur këtë problem dhe të raportojnë mbi ndikimin e masave të ndërmarra, pengesat dhe masat e mëtejshme të planifikuara. (iii) Statistikat dhe kontrolli gjyqësor– Komiteti kërkoi vlerësimin e statistikave dhe rezultateve të shqyrtimit gjyqësor të nevojës për mbajtje të mëtejshme, duke siguruar që pacientët psikiatrikë forenzikë të dëgjohen personalisht ose përmes përfaqësuesit të tyre. (iv) Stafi i specializuar – Autoritetet u ftuan të rrisin përpjekjet për të rekrutuar stafin e mjaftueshëm dhe të specializuar në Institucionin Special të Lezhës dhe të informojnë rregullisht Komitetin mbi përparimin në këtë drejtim. (v) Ndërtimi i një institucioni të përhershëm – Komiteti mirëpriti informacionin mbi planet për ndërtimin e një institucioni të përhershëm forenzik dhe financimin e tij, dhe i inkurajoi autoritetet të eksplorojnë mekanizma të ndryshëm financiarë, si në nivel kombëtar, ashtu edhe rajonal.

Masat që rekomandohen nga Avokatura e Shtetit: edhe pse Avokatura e Shtetit në vijimësi ka kërkuar marrjen e masave të përgjithshme nga institucionet e përfshira, duke qenë se çështja është komplekse, akoma nuk është arritur t'i jepet një zgjidhje përfundimtare zgjidhjes së këtyre problematikave.

Për sa më sipër, krahas masave që kërkohen nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës dhe që institucioni ynë i ka përcjellë të organet kompetente, rekomandojmë, në mënyrë të veçantë:

- Hartimi i një plani të qartë për krijimin e një institucioni të përhershëm të specializuar forenzik (nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë), duke përfshirë sigurimin e financimit dhe vendosjen e një afati konkret për ndërtimin, për të trajtuar personat që kanë kryer vepra penale dhe janë shpallur të papërgjegjshëm nga gjykatat, pasi futja e tyre në institute të vuajtjes së dënimit konsiderohet shkelje.

- Nga Ministria e Drejtësisë të vlerësohet marrja e masave për ndryshime ligjore, në mënyrë që dhe personat e shpallur të papërgjegjshëm, që mbahen padrejtësisht në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe jo në institucione të specializuara, të përfitojnë kompensim financiar në këto raste, sikurse përfitojnë personat që bëjnë burgim të padrejtë.

- **“Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë”**

Grup çështjet “Luli” kanë të bëjnë me tejzgjatjen e tepruar të proceseve civile, administrative dhe penale dhe, në fazën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, si dhe mungesën e një mjeti juridik efektiv ankimi.

Në këto vendime, Gjykata Evropiane ka kritikuar, ndër të tjera, dështimin e sistemit gjyqësor për të menaxhuar shqyrtimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, si dhe zhvillimin e procedurave për të njëjtën çështje në gjykata të ndryshme apo rikthimin e çështjeve në mënyrë të vazhdueshme për rigjykim nga gjykatat më të larta në ato më të ulta (shkelje e nenit 6 § 1).

Gjykata Evropiane ka vënë në dukje se zgjatja e tepërt e procedurave është kthyer në një mangësi serioze dhe ka theksuar nevojën për të miratuar masa të përgjithshme dhe miratimin e një mjeti juridik të brendshëm përshpejtues dhe kompensues për tejkthyerjen e procedurave.

Mbledhja e fundit e Komitetit të Ministrave: Gjatë vitit 2025 Komiteti i Ministrave nuk ka marrë në shqyrtim masat individuale dhe masat të përgjithshme të ndërmarra nga autoritetet shqiptare për ekzekutimin e këtij vendimi.

Mbledhja e fundit ka qenë në datat, 3-5 dhjetor 2024, ku u miratua dhe rezoluta lidhur me masat e ndërmarra nga autoritet shqiptare për ekzekutimin e vendimit “Luli dhe të tjerë”.

Gjetjet dhe rekomandimet kryesore të Komitetit të Ministrave:

Komiteti vlerëson progresin e bërë në plotësimin e vendeve vakante të gjyqtarëve, ekzaminimin brenda një kohe të arsyeshme të çështjeve para Gjykatës Kushtetuese dhe fillimin e zvogëlimit të “backlog”-ut në Gjykatën e Lartë, megjithatë vuri në dukje me shqetësim rritjen e numrit të çështjeve të pashqyrtuara dhe kohëzgjatjen mesatare të lartë të gjykimeve në shumicën së gjykatave të apelit dhe sfidat që ende ndikojnë në punën e disa prej gjykatave të shkallës së parë, lidhur me përqindjen e lartë të vakancave për gjyqtarë dhe personel tjetër;

Komiteti gjithashtu përshëndeti, përfundimin e procesit të vettingut në shkallën e parë dhe u bëri thirrje autoriteteve të sigurojnë përfundimin e gjykimeve të apelit në çështjet e rivlerësimit përpara afatit kushtetues të qershorit 2026 dhe të përdorin të gjitha mjetet për të përshpejtuar emërimet në gjyqësor, dhe për të siguruar shpërndarjen e duhur të emërimeve të gjyqtarëve, ngarkesën e punës dhe mbështetjen nga stafi i administratës gjyqësore për gjykatat më të mbingarkuara.

Sic e thamë dhe më lart, tejkthyerja e procedurave gjyqësore, administrative apo ato të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore vendase, janë tashmë një praktikë e konsoliduar shkeljesh kundër Shqipërisë. Miratimi i ndryshimeve ligjore të Kodit të Procedurës Civile në vitin 2017 (neni 399/1 e vijues të tij), i cili përshiu një kapitull për konstatimin e shkeljes së tejkthyerjes së procedurave dhe shpërblimin e drejtë për një shkelje të tillë, nuk po jep efektin e dëshiruar, për shkak të masave të marra për reformën në drejtësi (*Procesi i vettingut*). Mungesa e gjyqtarëve dhe mosmarrja e masave që t’i japin zgjidhje çështjes në themel nga gjyqësori (KLGJ), ka bërë që stoku i çështjeve në pritje për tu gjykuar të rritet në mënyrë të konsiderueshme dhe mjeti efektiv i parashikuar në Kodin e Procedurave Civile të mos jetë më efektiv.

Përparimi i mëtejshëm në adresimin e këtij grupi çështjesh dhe mbyllja e mbikëqyrjes nga Komiteti i Ministrave varen nga zbatimi i plotë i një serie masash kyçe, duke përfshirë:

- Sigurimin e efektivitetit praktik të mekanizmit të përshpejtimit dhe kompensimit për tejkthyerjen e procedurave;
- Përfundimin e procesit kalimtar të rivlerësimit dhe apeliemeve përkatëse brenda afateve kushtetuese;
- Plotësimin e vakancave në gjyqësor;
- Zbatimin e Strategjisë për reduktimin e stokut të çështjeve;
- Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative në gjykata;
- Funkcionalizimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

Një problem specifik është se gjykimet për konstatimin e tejzgjatjes së afateve kanë një afat 45 ditor, por në praktikë vendimet shpesh vonohen me muaj, duke zhvlerësuar efektivitetin e mekanizmit efektiv.

Masat e rekomanduara nga Avokatura e Shtetit:

- Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të plotësojë vakancat në të gjitha gjykatat e vendit, veçanërisht në gjykatat e apelit, sipas kërkesave të GJEDNJ-së.
- Në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të vlerësojë masat e deritanishme dhe të hartojë një plan konkret për uljen e numrit të çështjeve të papërfunduara (backlog), duke përfshirë të gjitha gjykatat, me fokus të veçantë në Gjykatën e Lartë.
- Kolegji i Posaçëm i Apelimit (tashmë Gjykata Kushtetuese) duhet të sigurojë përfundimin e procesit të vlerësimit të ankimeve lidhur me rivlerësimin e gjyqtarëve brenda afateve kushtetuese.

Për të rritur efektivitetin e mekanizmit të kompensimit dhe përshpejtimin të procedurave, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD), brenda kompetencave të tij, duhet të kryejë inspektime tematike për të verifikuar respektimin nga gjykatat e afateve të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile. Edhe pse ligji parashikon afate të qarta dhe të shkurtra, praktika tregon se ato shpesh nuk respektohen, duke rrezikuar funksionimin e mekanizmit si një mjet efektiv. Monitorimi sistematik dhe marrja e masave disiplinore, kur është e nevojshme, mund të shërbejnë si nxitje konkrete për respektimin e ligjit.

• **X dhe të tjerë kundër Shqipërisë**

Në vendimin në fjalë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka konstatuar shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 12 të Konventës në lidhje me pretendimet e kërkuarve për diskriminim për shkak të politikave të ndjekura, që kishin çuar në segregim në shkollën fillore "Naim Frashëri" e cila frekuentohej pothuajse ekskluzivisht nga fëmijët romë dhe egjiptianë.

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Në tetor dhe nëntor 2025, Avokatura e Shtetit ka dërguar informacion të përditësuar lidhur me masat individuale dhe të përgjithshme për ekzekutimin e vendimit "X dhe të tjerë k. Shqipërisë". Në mënyrë të përmbledhur Avokatura ka raportuar lidhur me masat e ndërmarra për të monitoruar, regjistrimin e fëmijëve, caktimin e mediatorëve, masat kundër braktisjes së shkollës në shkollën "Naim Frashëri", dhënien e bursave, ofrimin e shërbimeve sociale, trajnimet për arsimin gjithëpërfshirës për mësuesit në shkollë, aktivitetet e ndryshme jashtëshkollore dhe komunitare.

Në këtë kontekst janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me organizatat e shoqatave romë si dhe në bashkëpunim me zyrën e KiE janë organizuar takime në shkollën Naim Frashëri, si dhe me institucionet e linjës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si dhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.

Mbledhja e Komitetit të Ministrave për ekzaminimin e çështjes "X dhe të tjerë": Në datat, 2-4 dhjetor 2025, Komiteti i Ministrave ka shqyrtuar për herë të parë masat individuale dhe masat e përgjithshme të ndërmarra nga autoritetet shqiptare për ekzekutimin e këtij vendimi.

Në fund të mbledhjes u miratua dhe rezoluta lidhur me masat e ndërmarra nga autoritetet shqiptare për ekzekutimin e vendimit, ndër të cilat përmendim gjetjet dhe rekomandimet kryesore:

- Komiteti vlerësoi zhvillimin e Studimit të Eficiencës për shkollën "Naim Frashëri" dhe iniciativat komunitare në Korçë, përfshirë emërimin e një Mediatori Kulturor, si dhe masat për arsim gjithëpërfirës .

-

- Megjithatë, Komiteti vëren se shkolla “Naim Frashëri” mbetet e segreguar, dhe disa shkolla të tjera kanë mbipopullim të nxënësve Rom dhe Egjiptian. Autoritetet inkurajohen të ndërmarrin veprime vendimtare për të eliminuar segregimin dhe të zbatojnë rekomandimet e Studimit të Efëncës.
- Gjithashtu Komiteti theksoi se duhet të raportohen rezultatet e Planit Kombëtar të Veprimit 2021-2025 për barazi dhe përfshirje, si dhe të sigurohet një vlerësim kombëtar për situatën e segregimit në shkolla. Komiteti kërkon të dhëna statistike të detajuara, monitorim efektiv dhe identifikim të shpejtë të tendencave të segregimit, si dhe vlerësim të progresit të masave të ndërmarra.
- Autoritetet duhet të vlerësojnë forcimin e kuadrit ligjor të zonave shkollore dhe masat për qasje praktike të nxënësve dhe prindërve në arsim inkluziv.

Rekomandim i Avokaturës së Shtetit: Vlerësojmë se duke pasur parasysh se çështja e segregimit në edukim po ndiqet dhe në kuadër të negociatave të Shqipërisë me BE-në, do të duhet të ndiqet me prioritet nga Ministria e Arsimit, pasi vërejmë se ka një vëmendje të shtuar për këtë çështje dhe përpjekje për ta konsideruar si një problem të përgjithshëm e jo të veçuar vetëm për shkollën Naim Frashëri.

- **Sharxhi dhe të tjerë k. Shqipërisë**

Në vendimin “Sharxhi dhe të tjerë k. Shqipërisë”, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka gjetur shkelje sa i përket nenit 6/1 të Konventës, lidhur me mos respektimin nga organet administrative të vendimeve të ndërmjetme të gjykatës dhe mungesës së mjetit efektiv për t’u ankuar lidhur me mos respektimin e vendimit të ndërmjetëm nga ana e autoriteteve (neni 13 së bashku me nenin 6/1 të Konventës). Gjithashtu, u konstatua shkelje e Nenit 1 të Protokollit 1, së bashku me nenin 13 lidhur me ndërhyrjen e shtetit shqiptar në shpronësimin e kërkuësve dhe prishjen e ndërtesës, konfiskimin dhe vendosjen e shiritit rreth ndërtesës.

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Avokatura e Shtetit gjatë vitit 2025, ka informuar Komitetin e Ministrave në lidhje me ekzekutimin e masave individuale dhe të përgjithshme për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ “Sharxhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”.

Në tetor 2025, është paraqitur pranë Komitetit të Ministrave informacion i përditësuar lidhur me ekzekutimin e vendimit, duke parashtruar qëndrimin e autoriteteve tona sa i përket vështirësive të hasura për ekzekutimin e vendimit.

Mbledhja e fundit e Komitetit të Ministrave të KiE: Në datat 2-4 dhjetor 2025, u zhvillua mbledhja e radhës e Komitetit të Ministrave për të Drejtat e Njeriut, në të cilin u miratua dhe vendimi i Komitetit mbi masat e ndërmarra nga autoritetet shqiptare për ekzekutimin e vendimit “Sharxhi dhe të tjerë k. Shqipërisë” (kërkesa nr.10613/16), i cili u bën thirrje autoriteteve të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e pagesës, përfshirë interesin e vonësës, dhe të përfshijnë, kur është e përshtatshme, kërkuësit ose përfaqësuesit e tyre në diskutimet për pagesën.

- **“Durdaj dhe të tjerë kundër Shqipërisë”**

Në datën 07.11.2023, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (më poshtë GJEDNJ), ka dalë me vendim për çështjen “Durdaj dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, kërkesa nr.63543/09. Vendimi është bërë përfundimtar në datën 07.02.2024. Kërkesa ka të bëjë me shpërthimin në fabrikën e demontimit të armëve, makinerive dhe pajisjeve të vjetra të Forcave të Armatosura në Gërdec, që rezultoi në humbjen e jetës 26 personave.

Gjykata konstaton shkelje të nenit 2 lidhur me mungesën e përfshirjes së kërkuësve në procesin gjyqësor penal kundër të njëzet e nëntë të akuzuarve dhe mënyrën se si autoritetet shqiptare kanë trajtuar ndjekjen penale të zotit F.M, procesi ndaj të cilit siç vëren Gjykata vazhdon ende.

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Në 7 gusht 2024, Avokatura e Shtetit dërgoi informacion paraprak lidhur me masat individuale sa i përket ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së “Durdaj k. Shqipërisë”. Në datën 14 tetor 2024 u dërgua Plani i Veprimit për ekzekutimin e masave të përgjithshme dhe individuale lidhur me këtë çështje, ku Komiteti i Ministrave u informua lidhur me ecurinë e procesit penal të ish Ministrit të Mbrojtjes, si dhe masat e përgjithshme sa i përket ndryshimeve ligjore për të garantuar të drejtat e të dëmtuarve në procesin penal dhe masat e ndërmarra për të rritur efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale, në kuadër të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale dhe reformës në drejtësi.

Mbledhja e Komitetit të Ministrave të KiE. Në 10-12 qershor 2025, Komiteti i Ministrave për herë të parë mori në shqyrtim masat individuale dhe ato të përgjithshme lidhur me ekzekutimin e këtij vendimi nga Shqipëria. Në fund të mbledhjes miratoi dhe një vendim në të cilin evidentohet si më poshtë vijon:

Lidhur me masat individuale: Komiteti i Ministrave ka kërkuar që autoritetet të marrin masat e nevojshme për të parandaluar vonesa të mëtejshme në gjykimin kundër ish-Ministrit të Mbrojtjes për shpërdorim detyre. Autoritetet gjithashtu duhet të sigurojnë pjesëmarrjen efektive të anëtarëve të familjeve të viktimave dhe përfaqësuesve të tyre gjatë mbledhjes së provave dhe në procesin e ankimeve.

Masat e përgjithshme: Komiteti vëren se reforma kushtetuese dhe ligjore ka forcuar pavarësinë e prokurorëve dhe të drejtat e viktimave gjatë fazës paraprake të hetimeve, por ka kërkuar informacion të mëtejshëm mbi zbatimin praktik të këtyre masave, veçanërisht në hetimet për funksionarët e rangut të lartë për ngjarje me humbje jete ose dëmtime të rënda.

- **“Nika kundër Shqipërisë”**

Në datën 14.11.2023, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (më poshtë GJEDNJ), ka dalë me vendim për çështjen “Nika k. Shqipërisë” (kërkesa nr. 1049/17). Vendimi është bërë përfundimtar në datën 14.02.2024.

Çështja ka të bëjë me vdekjen e bashkëshortit dhe babait të kërkueseve, pasi ishte qëlluar me një plumb në kokë në vitin 2011, gjatë një proteste përpara Kryeministrit, në të cilën kishte pasur përballje të dhunshme midis demonstruesve dhe autoriteteve. Kërkuetit pretenduan në veçanti se, komandanti i përgjithshëm i Gardës së Republikës, i ngarkuar me mbrojtjen e Kryeministrit, kishte urdhëruar vartësit e tij të hapnin zjarr ndaj protestuesve.

Gjykata, në përfundim të ekzaminimit të çështjes konstatoi se, ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si në aspektin material ashtu dhe në atë procedural.

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Në 5 nëntor 2024, Avokatura e Shtetit paraqiti pranë Komitetit të Ministrave, Planin e Veprimit për ekzekutimin e masave të përgjithshme dhe individuale lidhur me çështjen “Nika k. Shqipërisë”. Komiteti i Ministrave u informua lidhur me ecurinë e rihapjes së procesit penal sa i përket ngjarjeve të 21 janarit, si dhe në kuadër të masave të përgjithshme mbi ndryshimet në kuadrin ligjor për përdorimin e armëve të zjarrit dhe përdorimin e forcës vdekjeprurëse nga punonjësit e shtetit, në kontekst të tubimeve masive.

Mbledhja e Komitetit të Ministrave të KiE Në 10-12 qershor 2025, Komiteti i Ministrave për herë të parë mori në shqyrtim masat individuale dhe ato të përgjithshme lidhur me ekzekutimin e këtij vendimi nga Shqipëria. Në fund të mbledhjes miratoi dhe një vendim në të cilin evidentohet si më poshtë vijon:

Masat individuale: Komiteti ka vlerësuar rifillimin e hetimeve penale dhe ka inkurajuar autoritetet të kryejnë hetime të plota, të kujdesshme dhe brenda një afati të arsyeshëm.

Masat e përgjithshme: Komiteti vlerësoi pozitivisht kuadrin e ri ligjor për përdorimin e armëve të zjarrit, duke konstatuar se ai është në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 2 të Konventës, pasi parashikon përdorimin e tyre vetëm në raste rreziku për jetën dhe si mjet i fundit, si dhe përfshin garanci të shumta procedurale. Gjithashtu, u vlerësua ekzistenca e një kuadri të plotë për planifikimin dhe kontrollin e operacioneve policore gjatë tubimeve, si dhe organizimi i trajnimeve të shumta për autoritetet përkatëse.

Komiteti mori me interes informacionin se që prej vitit 2014 demonstratat janë zhvilluar në mënyrë paqësore dhe nuk janë regjistruar incidente të ngjashme me përdorimin e armëve të zjarrit nga agjentë shtetërorë, çka tregon ndikimin pozitiv të masave të miratuara, duke kërkuar njëkohësisht informacion mbi zbatimin e këtij kuadri në situata të tjera ku përdorimi i armëve lejohet.

U theksua se reformat kushtetuese dhe ligjore kanë forcuar pavarësinë e prokurorëve nga ndikimi politik dhe janë përshëndetur ndryshimet ligjore që synojnë forcimin e të drejtave të viktimave dhe personave që paraqesin kallëzim penal në fazën paraprake.

Komiteti ftoi autoritetet të informojnë mbi zbatimin praktik të këtyre reformave, veçanërisht lidhur me efektivitetin, shpejtësinë dhe seriozitetin e hetimeve, përfshirë përgjegjësinë penale të zyrtarëve të lartë, praktikën e prokurorisë dhe gjykatave për përdorimin e armëve të zjarrit nga agjentë shtetërorë, hetimet disiplinore dhe të dhënat statistikore përkatëse.

Gjithashtu, autoritetet u ftuan të sqarojnë mënyrën se si garantohet në praktikë e drejta e viktimave dhe familjarëve të tyre për pjesëmarrje në fazën e gjyqimit, përfshirë mbledhjen e provave dhe të drejtën e ankimit.

3.2 Vendime, ekzekutimi i të cilave ndiqet me procedurë normale

Gjatë vitit 2025, ka vijuar të ndiqet me prioritet ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ, sa i përket procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe është ndjekur dhe raportuar ekzekutimi i masave individuale dhe të përgjithshme për çështjet, *Jella, Veizi dhe Myrtaj e të tjerë, Kola, Topi, Malo, Hysi, Ibrahim i dhe të tjerë, Maci, Gaba, Cani, Meli dhe të tjerë, Zela, Biba kundër Shqipërisë, Ramaj kundër Shqipërisë.*

Lidhur me këto vendime, Avokatura e Shtetit ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me institucionet e brendshme respektive dhe Komitetin e Ministrave dhe Departamentin e Ekzekutimit të Vendimeve. Ndër planet e veprimit veçojmë:

1. Plani i Veprimit “Jella kundër Shqipërisë”

Çështja ka të bëjë me shkeljen e së drejtës së kërkuesve për gëzimin paqësor të pronës së tyre, sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës për shkak të mosekzekutimit të vendimeve të brendshme në favor të tyre.

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Sa i përket çështjes “Jella k. Shqipërisë”, në datën 4.1.2025, Avokatura e Shtetit ka paraqitur Planin e Veprimit në Komitetin e Ministrave lidhur me ekzekutimin e këtij vendimi, duke informuar mbi pagesën e shpërblimit të drejtë dhe mbi vijimin e procedurave gjyqësore lidhur me përcaktimin e kufijve të parcelës së tokës dhe

regjistrimin e titullit të pronësisë. Kjo çështje është kthyer për rishqyrtim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me një tjetër trup gjykues. Zyra e Avokatit të Shtetit ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me ATP-në, institucioni përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi.

2. Plani i veprimit “Biba kundër Shqipërisë”.

Çështja ka të bëjë me një sulm ndaj djalit të kërkuesit nga një nxënës tjetër në një shkollë private të frekuentuar nga ata të dy. Kërkuesi pretendoi shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e drejta për jetë familjare dhe private duke argumentuar se shteti kishte dështuar për të mbikëqyruar në mënyrë të përshtatshme një shkollë private të licencuar.

Gjykata konstatoi se Shteti Shqiptar nuk arriti të siguronte mbrojtje të mjaftueshme për djalin e kërkuesit ndërsa ishte në shkollë, duke rezultuar në shkelje të së drejtës së tij për jetë private sipas Nenit 8. Shkolla nuk monitoroi apo parandaloi nxënësit nga posedimi dhe përdorimi i objekteve të rrezikshme, si katapultat, gjë që çoi në një dëmtim të rëndë të djalit të kërkuesit

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Më datën 8.1.2025, Avokatura e Shtetit ka dërguar informacion të përditësuar lidhur me ekzekutimin e vendimit “Biba kundër Shqipërisë” duke përfshirë informacion lidhur me kuadrin ligjor për të garantuar sigurinë e fëmijëve në shkollat publike dhe private për të parandaluar incidente që rrezikojnë shëndetin dhe mirëqenien e studentëve. Gjithashtu është raportuar dhe mbi masat që janë marrë nga Ministria e Arsimit për të monitoruar zbatimin e legjislacionit përkatës, duke përfshirë dhe inspektimet e rregullta dhe periodike dhe mbikëqyrjen institucionale ndaj institucioneve arsimore në Shqipëri.

3. Plani i Veprimit “Zela k. Shqipërisë”

Çështja *Zela k. Shqipërisë* ka të bëjë me shembjen në vitin 2002 të një ndërtese trekatëshe që kërkuesi kishte ndërtuar në Tiranë, në bregun e lumit Lana. Autoritetet urdhëruan shembjen me arsyetimin se objekti ishte ndërtim i paligjshëm dhe shkelte rregullat e planifikimit urban për zonën.

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Në datën 11.3.2025 është dërguar Plani i Veprimit për çështjen “Zela k. Shqipërisë”, ku është informuar Komiteti i Ministrave, lidhur me masat individuale dhe të përgjithshme për ekzekutimin e këtij vendimi, vecanërisht sa i përket kuadrin ligjor që rregullon shpronësimin e pronës private, si dhe inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet pa leje, kompetencat e Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit dhe rolin e tij mbikëqyrës ndaj inspektorateve vendore, me qëllim parandalimin e abuzimeve.

4. Raporti i Veprimit “Ana Veizi dhe të tjerë kundër Shqipërisë” dhe “Myrtaj dhe të tjerë kundër Shqipërisë”.

Çështja lidhet me kërkesën, bazuar në nenet 2, 6 dhe 13 të Konventës, që kanë të bëjnë me efektivitetin e hetimit mbi vdekjen e familjarëve të kërkuesve gjatë protestës së zhvilluar më 21 janar 2011, si edhe me të drejtën e aksesit në gjykatë, për shkak të refuzimit të gjykatave vendase për të shqyrtuar kërkesën civile të kërkuesve për dëmshpërblim.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut pranoi një marrëveshje miqësore ndërmjet palëve, sipas së cilës autoritetet u angazhuan të paguajnë kërkuesve një shumë dëmshpërblimi dhe të sigurojnë rihapjen e procedimeve penale në nivel kombëtar për këtë çështje, me qëllim përfshirjen e familjarëve të viktimave. Gjithashtu, në çështjen “Veizi dhe Deda”, autoritetet u angazhuan të garantojnë shqyrtimin e kërkesës civile të kërkuesve për dëmshpërblim në procedimet vendase.

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Në datën 14.4.2025 dhe 25.11.2025 u dërgua në Komitetin e Ministrave, Raport i përditësuar mbi masat individuale dhe të përgjithshme të ndërmarra nga qeveria shqiptare për ekzekutimin e këtyre vendimeve të GJEDNJ-së, duke kërkuar mbylljen e monitorimit për ekzekutimin e këtyre vendimi. Më 10.12.2025, Komiteti i Ministrave mbylli monitorimin lidhur me ekzekutimin e këtyre vendimeve.

5. Plani i Veprimit “Meli dhe Swinkels Family Brewers N.V kundër Shqipërisë”, kërkesat Nr. 41373/21 dhe 48801/21

GJEDNJ ka konstatuar shkelje të nenit 6/1 të Konventës sa i takon procesit të rregullt ligjor, në lidhje me mungesën e arsytimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në rastet e rrëzimit të ankesave kushtetuese – si rezultat ose i votave të ndara në mënyrë të barabartë ose i mosarritjes së shumicës së kërkuar prej pesë gjyqtarësh për gjetjen e një shkeljeje kushtetuese.

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Lidhur me këtë çështje, në datën 17.4.2025 u përcoll pranë Komitetit të Ministrave Plani i Veprimit për ekzekutimin e këtij vendimi ku u informua mbi zhvillimet e fundit të praktikës së Gjykatës Kushtetuese në drejtim të dhënies së një arsytimi përmbledhës të qëndrimeve të shumicës dhe pakicës në çështje me përfundime të ngjashme me ato të kërkuar në rastin konkret.

6. Raporti i veprimit “Cani kundër Shqipërisë” kërkesa nr. 37474/20

Gjatë vitit 2025, është ndjekur me prioritet ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ, sa i përket procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku është raportuar dhe ndjekur ekzekutimi i masave individuale dhe të përgjithshme për çështjen, Cani kundër Shqipërisë.

Raportimi në Komitetin e Ministrave:Në datën 9.05.2025, Avokatura e Shtetit ka paraqitur Planin e Veprimit për ekzekutimin e këtij vendimi duke informuar Komitetin e Ministrave për masat e ndërmarra për rritjen e ndërgjegjësimit tek organet e drejtësisë, lidhur me shkeljet e konstatuara nga GJEDNJ në këtë vendim. Nga ana jonë është kërkuar mbyllja e shqyrtimit të kësaj çështje, duke konsideruar të ezazuara rekomandimet e GJEDNJ-së, sa i takon masave individuale dhe të përgjithshme.

Në datën 3 shtator 2025, Komiteti I Ministrave mbylli monitorimin për ekzekutimin e këtij vendimi.

7. Plani i Veprimit “Gaba k. Shqipërisë”

Në datën 17.12.2024, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka dalë me vendim për kërkesën nr. 17758/06 “Gaba kundër Shqipërisë”. Kërkesa ka të bëjë me pretendimet për shkelje të nenit 6/1 të Konventës, sa i takon parimit të sigurisë juridike, në lidhje me rishikimin e një vendimi të formës së prerë në një situatë të jashtëzakonshme.

Gjykata arriti në konkluzionin se, ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të anulimit të vendimit të vitit 2006 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pa rrethana thelbësore dhe bindëse që justifikojnë atë veprim.

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Në datën 22.9.2025, Avokatura e Shtetit ka paraqitur Planin e Veprimit për ekzekutimin e këtij vendimi, duke informuar Komitetin e Ministrave lidhur me masat individuale dhe të përgjithshme për ekzekutimin e këtij vendimi. Konkretisht është informuar mbi reformat ligjore dhe praktikën gjyqësore që kanë forcuar ndjeshëm respektimin e parimit të sigurisë juridike në Shqipëri. Ndryshimet në Ligjin “Për Avokaturën e Shtetit” kanë kufizuar kompetencat për rishikimin e vendimeve përfundimtare, duke e barazuar me çdo subjekt tjetër juridik dhe duke eliminuar diskrecionin e gjerë. Në fushën e pronës, reforma ligjore dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë kanë konsoliduar natyrën përfundimtare dhe kuazi-gjyqësore të vendimeve të komisioneve të kthimit dhe kompensimit, duke lejuar kundërshtimin e tyre vetëm brenda afateve të qarta ligjore ose përmes mjeteve të jashtëzakonshme.

8. Plani i Veprimit “Ibrahimi dhe të tjerë k. Shqipërisë”

Çështjet në fjalë kanë të bëjnë me procedura gjyqësore vendase, ku kërkuarit parashtronin ankesat e tyre kushtetuese ndaj vendimeve respektive të Gjykatës së Lartë. Në të gjitha çështjet, Gjykata Kushtetuese i ka shpallur ankesat kushtetuese të kërkuarve të papranueshme, pasi ishin paraqitur jashtë afatit katër mujor. Sipas vlerësimit të saj, Gjykata Kushtetuese e fillon

përlllogaritjen e afatit nga data e miratimit të vendimeve të Gjykatës së Lartë, dhe jo prej datës në të cilën kërkuesit kishin marrë dëjshëm efektivisht për të.

Në vendimin “Ibrahimi dhe të tjerë k. Shqipërisë”, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut deklaroi se ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës, në lidhje me të drejtën e kërkuesve për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Në datën 24.10.2025, Avokatura e Shtetit ka paraqitur Planin e Veprimit për ekzekutimin e këtij vendimi, duke informuar Komitetin e Ministrave lidhur me masat individuale dhe të përgjithshme për ekzekutimin e këtij vendimi. Konkretisht është informuar mbi ndryshimet ligjore në Kodin e Procedurës Civile të 2017, afatet për ushtrimin e ankimit dhe masat e ndërmarra nga Gjykata e Lartë për forcimin e sistemit të njoftimeve elektronike, duke përfshirë dërgimin e akteve edhe përmes emailit, përmirësimin e mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave të palëve dhe avokatëve.

9. Raporti i Veprimit “Topi k. Shqipërisë”

Çështja ka të bëjë me pamundësinë e kërkuesit, pasi është gjykuar në mungesë, për një rishqyrtim të plotë të themelit të akuzave nga gjykatat vendase në një proces në përputhje me garancitë e një gjykimi të drejtë sipas nenit 6 të Konventës. Gjithashtu, çështja lidhet me mohimin e së drejtës së kërkuesit për akses në Gjykatën Kushtetuese lidhur me ankimin kushtetues kundër dënimit të dhënë në mungesë, duke përbërë shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Në datën 25.11.2025, Avokatura e Shtetit ka paraqitur Raporin e Veprimit për ekzekutimin e këtij vendimi, duke kërkuar mbylljen e kësaj çështjeje dhe duke informuar Komitetin e Ministrave lidhur me masat individuale dhe të përgjithshme për ekzekutimin e saj. Konkretisht është informuar për ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, që tashmë në përputhje me standardet e Konventës parashikojnë mundësinë e rihapjes së çështjeve të gjykuara në mungesë (trial in absentia) dhe trajnimet/masat ndërgjegjësuese për gjyqtarët dhe prokurorët.

10. Raporti i Veprimit “Hysi k. Shqipërisë” & Raporti i Veprimit “Malo k. Shqipërisë” (çështje të ngjashme)

Edhe këto çështje kanë të bëjnë me mungesën e garancive në lidhje me procedurat penale të zhvilluara në mungesë kundrejt kërkuesve dhe pamundësinë së tyre për të pasur nga gjykatat vendase një rivlerësim të ri të çështjes penale kundrejt tyre (shkelje e Nenit 6 § 1).

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Avokatura e Shtetit, ka paraqitur pranë Komitetit të Ministrave të KiE, më datë 25.11.2025 “Raportin e Rishikuar të Veprimit” për ekzekutimin e këtij vendimi duke informuar mbi ndryshime ligjore të Kodit të Procedurës Penale që krijojnë mundësinë për rivlerësim të akuzave penale pas gjykimeve në mungesë, duke garantuar të drejtën e aksesit në gjykatë dhe shqyrtimin e ri të provave, si dhe për trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës mbi gjykimin në mungesë dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së.

11. Raporti i Veprimit “Kola k. Shqipërisë”

Kjo çështje i përket grup çështjeve “Çela” që kanë të bëjnë me shkeljen e nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me të drejtën e kërkuesve për akses në Gjykatën Kushtetuese, duke qenë se Gjykata Kushtetuese nuk kishte pranuar të shqyrtonte kërkesën e ankuesit, për shkak të aplikimit të afatit të ri katër mujor.

Raportimi në Komitetin e Ministrave: Lidhur me këto çështje Avokatura e Shtetit ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me Departamentin e Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ-së për të realizuar mbylljen e tyre.

Në datën 25.11 2025, Avokatura e Shtetit ka paraqitur Planin e Rishikuar të Veprimit për ekzekutimin e këtij vendimi, duke informuar Komitetin e Ministrave për ndryshimin e praktikës së Gjykatës Kushtetuese lidhur me llogaritjen e afatit të ankimit dhe masat për rritjen e ndërjegjësimin lidhur me shkeljet e konstatuara nga GJEDNJ. Më 10.12.2025, Komiteti i Ministrave mbylli monitorimin lidhur me ekzekutimin e këtij vendimi.

Gjithashtu, në 15 tetor 2025 Komiteti i Ministrave mbylli monitorimin e çështjes *“Gëllçi k. Shqipërisë”* ku Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të nenit 5 § 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se gjykatat vendase kishin dështuar për të dhënë arsyet e duhura dhe të mjaftueshme që do të justifikonin privimin e lirisë së kërkuesit, sa i përket periudhës së paraburgimit.

12. Plani i Veprimit “Ramaj k. Shqipërisë”

Në vendimin “Ramaj k. Shqipërisë”, i cili u bë përfundimtar më 28.4.2025, Gjykata arriti në përfundimin se *dështimi i autoriteteve për të respektuar vendimin përfundimtar dhe detyruet të gjykatës i imponoi kërkuesit një barrë joproporcionale dhe të tepruar dhe se autoritetet nuk kanë arritur të arrijnë një ekuilibër të drejtë midis kërkesave të interesit publik nga njëra anë dhe të drejtës së kërkuesit për gëzimin paqësor të pasurisë së tij nga ana tjetër. Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me pjesën e tokës që nuk është e zënë nga ndërtime pa leje.*

Avokatura e Shtetit me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë dhe në kuadër të projektit D-REX III (BE dhe KE, për forcimin e të drejtës së pronës dhe zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së) ka ndjekur me prioritet ekzekutimin e këtij vendimi, duke zhvilluar disa takime ndër-institucionale për analizimin e vendimit dhe identifikimin e shkaqeve të shkeljes dhe përcaktimin e masave për adresimin e tyre.

Janë zhvilluar disa tryeza diskutimesh me ekspertë dhe konsultime institucionale me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Agjencinë për Trajtimin e Pronës dhe Departamentin për Zbatimin e Vendimeve. Këto tryeza u fokusuan te analizimi i gjetjeve të Gjykatës, shqyrtimin e sfidave strukturore në regjistrimin e pronave dhe zbatimin e vendimeve, si dhe rishikimin e reformave dhe masave të marra në kuadër të axhendës së integritimit në BE.

Në kuadër të këtij projekti u hartua dhe një studim mbi aspektet strukturore të regjistrimit të pronave dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore. Studimi identifikoi mangësitë ligjore dhe institucionale si dhe formuloi rekomandime konkrete për forcimin e sigurisë ligjore dhe koordinimit ndër-institucional.

4. AKTIVITETE DHE PROJEKTE TË AVOKATURËS SË SHTETIT

- Raporti mbi ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Në përmbushje të detyrimeve ligjore sipas nenit 19/2 të Ligjit 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, Avokatura e Shtetit ka hartuar dhe paraqitur raportin mbi ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përpara Komisionit të Përhershëm për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në të cilin u informua për vendimet e GJEDNJ-së, çështjet që janë në procedurë ekzekutimi, raportimet në Komitetin e Ministrave të KiE-së, si dhe masat e ndërmarra për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

- Pjesëmarrje në projekte

Avokatura e Shtetit ka vijuar të jetë pjesëmarrëse aktive në projektin e përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës *“Mbështetje për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për lehtësimin e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ në Shqipëri”*. Në kuadër të këtij projekti, gjatë vitit 2025 janë zhvilluar aktivitete trajnuese me synim rritjen e kapaciteteve të Avokaturës së Shtetit në zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së.

Aktivitetet e vitit 2025 kanë qenë të fokusuar te ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ “*Gëllçi kundër Shqipërisë*” “*Ramaj kundër Shqipërisë*”, si dhe “*X dhe të tjerë kundër Shqipërisë*”. Në këtë kontekst, në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës, janë organizuar takime dhe trajnime me përfaqësues të institucioneve vendore dhe qendrore.

Ndërkohë që në kuadër të bashkëpunimit me Zyrën e Këshillit të Evropës, Avokatura e Shtetit ka qenë pjesëmarrëse dhe kontribuese në takimet e projektit të “Rritjes së standardeve të të drejtave të njeriut në burgjet në Shqipëri, në kontekst dhe të ekzekutimit të vendimit “*Srazimiri kundër Shqipërisë*”.

- **Pjesëmarrje në grupe pune dhe raportime të ndryshme**

Avokatura e Shtetit gjithashtu ka dhënë kontribut periodik në kuadër të negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian në kuadër të kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, si dhe “Rule of Law Report”.

Kontribut periodik është dhënë dhe sa i përket plotësimit pyetësorit të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë “**Dashboard Western Balkans**”, “Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë”, si dhe Raportimit në kuadër të Deklaratës së Risqeve Fiskale.

- **Vizita nga Departamenti i Ekzekutimeve të Vendimeve të GJEDNJ-së**

Pavarësisht se është vizitë në vitin 2026, në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve shqiptare dhe Këshillit të Europës, vlen të theksohet se në muajin Maj 2026, përfaqësues të lartë të Departamentit të Ekzekutimeve të Vendimeve të GJEDNJ-së, në shoqërimin e Avokaturës së Shtetit zhvilluan disa takime të rëndësishme me përfaqësues të institucioneve të përfshira dhe përgjegjëse për ekzekutimin e masave individuale dhe të përgjithshme, në disa vendimeve të GJEDNJ-së, në të cilën u diskutuan mbi mundësitë konkrete dhe masat që mund të merren për ekzekutimin e tyre.

Konkretisht u zhvilluan takime në: Ministrinë e Arsimit në lidhje me ekzekutimin e masave të përgjithshme për çështjen “*X dhe të tjerë k.Shqipërisë*”, në Ministrinë e Shëndetësisë, për masat e përgjithshme në lidhje me çështjet “*Srazimiri k.Shqipërisë*” dhe “*X dhe të tjerë k.Shqipërisë*”, me Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me ekzekutimin e masave individuale për çështjet “*Srazimiri k.Shqipërisë*”, çështjet e pronave, çështjet “*Luli dhe të tjerë k.Shqipërisë*”; Me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokuroritë e Rrethit Tiranë dhe Vlorë, në lidhje me ekzekutimin e masave individuale në disa çështje penale, me Këshillin e Lartë Gjyqësor në lidhje me masat e marra për grup çështjet “*Luli k.Shqipërisë*”, si dhe me Këshillin e Ministrave në lidhje me masat individuale për ekzekutimin e vendimit “*Sharxhi dhe të tjerë k.Shqipërisë*”.